



ProCredit Bank

Albania

Raporti Vjetor 2013

Treguesit Kryesorë

	EUR '000		LEK '000		Ndryshimi LEK
	2013	2012	2013	2012	
Pasqyra e Bilancit					
Asete Totale	287,874	286,409	40,360,109	39,979,809	1.0%
Portofoli Bruto i Kredisë	176,412	171,655	24,732,977	23,961,287	3.2%
Portofoli i kredisë Biznes	133,993	133,158	18,785,810	18,587,517	1.1%
< USD 10,000	20,234	21,823	2,836,787	3,046,271	-6.9%
> USD 10,000 < USD 30,000	28,293	29,220	3,966,690	4,078,841	-2.7%
> USD 30,000 < USD 150,000	49,979	48,824	7,007,046	6,815,328	2.8%
> USD 150,000	35,487	33,291	4,975,286	4,647,078	7.1%
Portofoli i Kredisë Agro	25,544	21,502	3,581,326	3,001,525	19.3%
Portofoli i Kredisë Rinovim Shtëpie	9,285	10,093	1,301,806	1,408,870	-7.6%
Të tjera	7,589	6,901	1,064,035	963,375	10.4%
Provizionet për Kreditë e Humbura (LLP)	-12,433	-8,500	-1,743,101	-1,186,510	46.9%
Portofoli Neto i Kredisë	163,979	163,155	22,989,875	22,774,778	0.9%
Depozita të Klientëve	231,399	228,061	32,442,106	31,835,025	1.9%
Detyrime në Banka dhe Institucione të tjera (duke përfshirë PCH)	11,908	15,393	1,669,556	2,148,662	-22.3%
Kapitali Total	33,482	31,736	4,694,126	4,430,007	6.0%
Pasqyra e të ardhurave					
Të Ardhura Operative	12,897	15,905	1,808,998	2,210,889	-18.2%
Shpenzime Operative	14,171	15,454	1,987,730	2,148,205	-7.5%
Fitimi Operativ Para Tatimit	-1,274	450	-178,732	62,684	-385.1%
Fitimi Neto	-1,193	430	-167,304	59,824	-379.7%
Raporte Kryesore					
Raporti të Ardhura Kosto	76.76%	76.82%			
Kthimi i Kapitalit	-3.67%	1.36%			
Raporti i Kapitalit	14.27%	13.54%			
Statistika Operacionale					
Numri i klientëve	105,534	120,864			-12.7%
<i>Prej të cilëve janë Klientë Biznesi</i>	20,906	24,305			-14.0%
Numri i Kredive Aktive	21,019	22,919			-8.3%
Numri i llogarive	167,003	171,579			-2.7%
Numri i Punonjësve	429	569			-24.6%
Numri i degëve dhe Njësive të Biznesit	30	37			-18.9%

Monedha vendase kundrejt Euros 31:

2013: EUR 1 = LEK 140.2

2012: EUR 1 = LEK 139.59

Kursi mesatar i këmbimit kundrejt Euros:

2013: EUR 1 = LEK 140.27

2012: EUR 1 = LEK 139.01

Misioni i Bankës	4
Letër nga Bordi Drejtues	5
Deklarata Gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e Gjendjes Financiare	8
Adresat dhe Kontaktet	42



Misioni i Bankës

ProCredit Bank është një bankë e orientuar drejt zhvillimit dhe ofron shërbim të plotë bankar. Ne ofrojmë shërbim cilësor për individët dhe bizneset. Në veprimet tona ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën në komunikimin tonë me klientët, ne nuk promovojmë kreditë konsumatore dhe sigurojmë shërbime të cilat janë të bazuara në situatën e çdo klienti dhe analizën financiare. Kjo përfaqëje e përgjegjshme na lejon të ndërtojmë një marrëdhënie afatgjatë me klientët tanë të bazuar në besimin reciprok.

Fokusi ynë është ofrimi i shërbimit për sipërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe i japin një kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë.

Duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese për klientët tanë individë si dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukim financiar, ne kemi për qëllim të promovojmë kulturën e kursimit, e cila mund të sjellë një qëndrueshmëri dhe siguri për familjet e zakonshme.

Aksionerët tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi, por nuk janë kryesisht të interesuar për maksimizimin afatshkurtër të fitimit. Ne investojmë shumë në trajnimin e personelit tonë, për të krijuar një mjedis pune të kënaqshëm dhe efikas, si edhe për t'u siguruar klientëve tanë shërbimin më miqësor dhe më konkurrues në treg.

Letër nga Drejtoria Ekzekutive

Gjatë vitit 2013, ProCredit Bank Shqipëri forcoi më tepër pozicionin e saj në treg si një institucion i përgjegjshëm financiar, duke ofruar shërbime cilësore për biznesin e vogël e të mesëm, pavarësisht situates jo të qëndrueshme makroekonomike. Ne vazhduam t'i konfirmojmë klientëve tanë vlerat tona të një banking të përgjegjshëm dhe të drejtë, duke analizuar në mënyrë cilësore situatën financiare të bizneseve, duke ofruar standarde të larta të kujdesit ndaj klientit si dhe një komunikim të hapur dhe transparent.

Edhe pse gjatë vitit që lamë pas mjedisi makroekonomik në Shqipëri u karakterizua nga kërkesë e ulët për investime nga sektori privat, ne realizuam një rritje të konsiderueshme të portofolit tonë të kredisë, duke ruajtur cilësinë në terma volumi dhe menaxhimi të vonesave.

Portofoli i kredisë në sistemin bankar pësoi një rënie të ulët, kryesisht e ndikuar nga portofoli i kredive të biznesit që pësoi një rënie prej 2% krahasuar me një vit më parë. Cilësia e portofolit të kredisë ishte ajo që pësoi përkeqësimin më të madh. Kreditë në vonesë arritën nivelin 23,5% - krahasuar me 22,5% në vitin 2012 - duke i detyruar në këtë mënyrë bankat që të fokusohen më shumë në cilësinë e dhënies së kredive.

Si një reagim ndaj kësaj situatë, ProCredit Bank Shqipëri, ndërmoi një sërë masash për të përmirësuar operacionet e veta të biznesit si dhe për të riorganizuar proceset e brendshme. Këto masa rritën pozicionin tonë konkurrues në treg si dhe përmirësuan parametrat e eficiencës dhe produktivitetit. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përditësimit të teknologjisë dhe shërbimeve financiare elektronike. Nëpërmjet platformës E-banking klientët tanë kanë mundësi të realizojnë vetë shumicën e transaksioneve, kudo që të ndodhen, në çdo kohë, duke u bërë në këtë mënyrë më të pavarur në përdorimin e shërbimeve financiare.

Gjatë vitit 2013, si pjesë e misionit dhe vizionit të Bankës, ne i kushtuam një vëmendje shumë të veçantë Edukimit Financiar. Nëpërmjet një fushate marketing aktive dhe gjithëpërfshirëse, ne rritëm ndërgjegjësimin dhe njohuritë mbi shërbimet bankare bazë, si kredia e biznesit dhe ajo konsumatore, në mënyrë që të realizohet një vendimmarrje bazuar në një informacion të saktë dhe të plotë. Për më tepër, gjatë vitit ne kemi promovuar kredinë për bizneset, duke nxitur krijimin e marrëdhënieve afatgjata bazuar në besimin reciprok dhe qëndrueshmërinë e institucionit, sesa bazuar në normat e interesave të shërbimeve.

Krahas modelit tonë të biznesit, qëndrueshmëria dhe stabiliteti i bankës sonë garantohet nga dhe nga aksioneri ynë i vetëm: ProCredit Holding, me qendër në Frankfurt, Gjermani.

Pavarësisht mjedisit ekonomik sfidues dhe kërkesës së ulët për kredi gjatë vitit 2013, portofoli ynë bruto i kredisë u rrit me 4,2 milionë Euro; më shumë se 11'000 kredi u disbursuan gjatë vitit, me një volum prej 98,2 milionë Euro; vazhduam të jemi lider në fushën e agrobiznesit me një portofol kredie prej 25,5 milionë Euro. Në fund të vitit kreditë me vonesë (Për >30 ditë) ishin në nivelin 9,87%. Ndërkohë, depozitatat qëndruan në të njëjtin nivel të vitit të mëparshëm, me 227,5 milionë Euro.

Në vitin 2014, ne do të vazhdojmë të jemi të fokusuar në cilësinë e portofolit të kredisë, ndërkohë që do të synojmë një rritje të qëndrueshme portofoli. Do të vazhdojmë të kemi të njëjtën përqasje ndaj biznesit, duke u bazuar në marrëdhënie afatgjatë, financime të projekteve të sukseshme të biznesit, si dhe këshillimit dhe monitorimit të vazhdueshëm financiar. Rol të vecantë do të vazhdojë të ketë sektori i agrobiznesit dhe investimet në projektet EKO.

Mënyra më e mirë për të qenë të sukseshëm, është të jesh eficient dhe të ofrosh një cilësi të lartë shërbimi, e cila do të thotë investim në cilësinë dhe kompetencat e punonjësve. Ne do të vazhdojmë të in-

vestojmë për zhvillimin personal dhe profesional të punonjësve tanë, nëpërmjet një sërë trainimesh që realizohen në nivel lokal dhe ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe Akademitë ProCredit, të cilat ofrojnë kurse për financën, bankingun, si dhe etikën dhe humanizmin. Ne jemi të përkushtuar të punësojmë individë me standarde të larta morale dhe integritet personal dhe profesional, cilësi këto që vlerësohen gjatë Programit Bankierët e Rinj - programi që duhet të perfundohej në mënyrë të suksesshme, si e vetmja mënyrë për t'u bërë pjesë e stafit të bankës.

Në prag të 20 vjetorit të ProCredit Bank Shqipëri, ne kemi besimin e plotë se, kemi një ndikim/impakt mjaft pozitiv në ekonominë shqiptare, si në biznesin e vogël dhe të mesëm, ashtu edhe për klientët private, duke ofruar shërbime novatore financiare që kanë synuar dhe synojnë të përmirësojnë standardet e jetesës dhe ekonominë e klientëve tanë.

Në emër të Bordit Drejtues, dua të shpreh mirënjohjen dhe respektin për të gjithë punonjësit e Bankës, për përkushtimin dhe rezultatet e arritura në këtë situatë jo të lehtë ekonomike. Një falenderim i veçantë shkon për më shumë se 105'000 klientët tanë për besimin që kanë treguar në vite tek ne.

Faleminderit



Adela Leka
Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive
ProCredit Bank sh.a.



Violeta Haxhillazi
Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive
ProCredit Bank sh.a.

Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive përgjatë vitit 2013

Flutura Veipi - Zëdhënëse e Drejtorisë Ekzekutive
Anila Denaj - Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive*
Adela Leka - Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive**
Violeta Haxhillazi - Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive

Këshilli Drejtues përgjatë vitit 2013

Borislav Kostadinov (Kryetar)
Claus-Peter Zeitinger
Anja Lepp
Sandrine Massiani
Wolfgang Bertelsmeier

* Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive deri më 2 Korrik 2013

** Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive prej 20 Majit 2013

Deklarata e Gjithëpërfshirëse

Në kuadër të përcaktimeve dhe parimeve të vendosura në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret e miratimit të administratorëve të tyre” Banka ProCredit sh.a. deklaron se:

Politikat e Shpërblimit

Në bazë të Statutit në fuqi të datës 15.7.2010 të Bankës ProCredit, Anetarët e Këshillit Drejtues, si dhe Anetarët e Komitetit të Kontrollit të Bankës, nuk paguhen për kryerjen e detyrave të tyre por marrin një dietë të përshtatshme për shpenzimet, e cila përcaktohet herë pas here nga Asambleja e Aksionerëve.

Tre anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive të Bankës ProCredit, si drejtuesit më të lartë ekzekutiv dhe në përputhje me profilin e riskut të bankës paguhen në bazë të një pagë mujore fikse shuma bruto e agreguar vjetore e së cilës është 19,658,480 Lekë.

Politikat e shpërblimit të bankës konsistojnë në shpërndarjen e pagës fikse mujore për punën në raport me pozicionin, eksperiencën, përgjegjësitë dhe detyrat që ka çdo punonjës, si dhe në mosdhënien e bonuseve shtesë.

Mënyra të tjera të shpërblimit për këto anëtarë jepen në formën e:

- Kuotave në kapitalin e shoqërisë Proinvest-Al sh.p.k.*
- Kontroll mjekësor falas një herë në vit

Në zbatim të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv përgjatë veprimtarisë së saj, Banka ProCredit harton dhe zbaton aktet e brendshme si më poshtë:

- Politika dhe procedura të administrimit të riskut
- Procedura për kriteret e emërimit dhe dokumentacionin për miratimin nga Banka e Shqipërisë të administratorëve të bankës
- Procedura e Përputhshmërisë Ligjore me Rregulloret e Jashtme

* Proinvest-Al shpk është një shoqëri e themeluar nga punonjësit e bankës PCB Shqipëri. Shoqëria ka për objekt të vetëm investimin në formën e blerjes dhe administrimit të aksioneve, që shoqëria IPC Invest GmbH & Co KG, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit gjerman, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Distriktit në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, mund të emetojë herë pas here. Qëllimi i IPC Invest GmbH & Co KG është të blejë dhe administrojë aksione në ProCredit Holding AG & Co. KGaA.

Pasqyra e Gjendjes Financiare

Pë vitin e përfunduar në 31 Dhjetor 2013.

Përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Raporti i Audituesit të Pavarur

Aksionereve dhe Bordit të Drejtoreve të ProCredit Bank sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare në vijim të ProCredit Bank sh.a., të cilat përmbledhin pozicionin financiar deri në datë 31 Dhjetor 2013, dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe fluksit të parave për vitin e mbyllur dhe një përmbledhje të politikave të rendesishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera.

Pergjegjesia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm, siç përcaktohet e nevojshme nga menaxhimi për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të cilat nuk kanë keqdeklarime materiale, qoftë si pasojë e mashtrimit ose gabimit.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare mbi Auditimin. Ato standarde kërkojnë që të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditin për të patur sigurinë e arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar fakte auditimi rreth shumave dhe zbulimeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e riskut të keqdeklarimeve financiare të pasqyrave financiare, si pasojë e mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e vlerësimit të riskut, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të rendesishëm për përgatitjen e subjektit dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedura auditimi të cilat janë të duhura në ato rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e pershtatshmerisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe të vlerësimeve të kontabilitetit të bera nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se fakti i auditit që kemi përfutur është i mjaftueshëm dhe i duhur për të siguruar një bazë për mendimin tonë auditues.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Blvd. Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Tower 1, 10th floor, Tirana, Albania
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 15 Korrik 2009 me numër identifikimi N.I.P.T. K91915023A



Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare paraqesin drejt, ne te gjitha pikepamjet pozicionin financiar te ProCredit sh.a. me date 31 Dhjetor 2013, dhe performancen financiare dhe fluksin e parase per vitin e mbyllur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
5 Maj 2014
Tirane, Shqiperi

Kodra
Eksperti Kontabel
Kledian Kodra, FCCA

ProCredit Bank Sh.a.

Pasqyra e Gjendjes Financiare me date 31 Dhjetor 2013

Pasqyra e pozicionit financiar

Shenime	ne LEK 31 Dhjetor		*ne EUR'000 31 Dhjetor		
	2013	2012	2013	2012	
Aktive					
Arka dhe llogarite me Banken Qendrore	5	8,815,821	7,529,390	62,880	53,939
Hua dhe parashenime ndaj bankave dhe institucioneve te tjera financiare	6	544,613	2,295,366	3,885	16,444
Hua dhe parashenime per klientet	7	22,989,875	22,774,778	163,979	163,155
Instrumente financiare te gatshme per shitje	8	4,992,866	4,479,782	35,612	32,092
Prona dhe pajisje	9	1,405,650	1,579,414	10,026	11,315
Aktive te patrupezuara	10	231,754	224,344	1,653	1,607
Prona nga investimet	11	56,836	54,436	405	390
Aktive nga tatimet e shtyra	12	31,401	21,031	224	151
Arketime nga tatimet mbi te ardhurat nga Korporatat	13	129,033	136,479	920	978
Aktive te tjera	14	1,162,260	884,789	8,290	6,338
Totali i aktiveve		40,360,109	39,979,809	287,874	286,409
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	15	759,295	1,169,768	5,416	8,380
Detyrime ndaj klienteve	16	32,442,106	31,835,025	231,399	228,061
Fonde te tjera te marra hua	17	910,261	978,894	6,493	7,012
Borxhi i varur	18	1,308,029	1,301,633	9,330	9,325
Detyrime te tjera	19	246,292	264,482	1,757	1,895
Totali i detyrimeve		35,665,983	35,549,802	254,395	254,673
Kapitali aksioner					
Kapitali aksioner	20	3,387,148	2,965,682	24,371	21,371
Rezerva ligjore	20	590,681	587,690	4,254	4,233
Rezerva perkthimi		-	-	(610)	(474)
Fitimi i pashpermdare		702,367	872,663	5,364	6,578
Rezerva rivleresimi		13,930	3,972	100	28
Totali i kapitalit aksioner		4,694,126	4,430,007	33,479	31,736
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		40,360,109	39,979,809	287,874	286,409

Shenimet shoqeruese nga faqja 7 deri 59 jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

Shifrat ekuivalente te Euros jane dhene vetem per qellim informimi dhe nuk jane pjese e pasqyrave financiare te audituara (shiko shenimin 2.2).

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga Drejtoria Ekzekutive
o me 31 Mars 2014 dhe jane nenshkruar nga:


Violeta Haxhillazi
Anetare e Bordit Drejtues




Elvira Tartari
Drejtoresh e Departamentit te Finances

Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse

Më date 31 Dhjetor 2013

Shënime	Në LEK '000		Në EUR '000*		
	2013	2012	2013	2012	
Interesa dhe të ardhura të ngjashme	21	3,367,202	3,604,396	24,005	25,929
Interesa dhe shpenzime të ngjashme	22	(1,224,097)	(1,264,838)	(8,727)	(9,099)
Të ardhura neto nga interesat		2,143,105	2,339,558	15,278	16,830
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	23	371,240	358,500	2,647	2,579
Shpenzime për tarifa dhe komisione	24	(80,734)	(73,239)	(575)	(527)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet		290,506	285,261	2,072	2,052
Të ardhura të tjera operative	25	96,606	102,935	689	740
Transaksione të kurseve të këmbimit minus humbje		13,005	11,595	93	83
Fitime të transaksioneve në valutë minus humbje		46,212	57,174	329	411
Tarifë zhvlerësimi për humbje kredie	7	(780,435)	(585,634)	(5,564)	(4,213)
Shpenzime të tjera operative	26	(1,987,730)	(2,148,205)	(14,171)	(15,454)
(Humbja)/Fitimi para tatimit mbi fitimin		(178,731)	62,684	(1,274)	449
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	28	11,427	(2,860)	81	(21)
(Humbja)/Fitimi për vitin		(167,304)	59,824	(1,193)	428
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:					
Ndryshime në rezervat e AFS		11,975	7,225	85	52
Tatime të shtyra mbi rezervat e AFS		(2,017)	(722)	(14)	(5)
Diferenca përkthimi		-	-	-	1
		9,958	6,503	71	48
Totali i të ardhurave të përgjithshme për vitin		(157,346)	66,327	(1,122)	476

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri 59 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

* Shifrat ekuivalente të Euros janë dhënë vetëm për qëllim informimi dhe nuk janë pjesë e pasqyrave financiare (shiko shënimin 2.2).

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

Më date 31 Dhjetor 2013

<i>Në LEK '000</i>	Kapitali Aksioner	Rezerva Ligjore	Rezerva Rivlerësimi (Deficit)	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
Balanca më datë 1 Janar 2012	2,965,682	537,409	(2,532)	863,120	4,363,679
Ndryshime në rezervat e AFS	-	-	7,227	-	7,227
Tatime të shtyra mbi rezervat e AFS	-	-	(723)	-	(723)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	6,504	-	6,504
Fitimi i vitit	-	-	-	59,824	59,824
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	6,504	59,824	66,328
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	50,281	-	(50,281)	-
Balanca më datë 31 Dhjetor 2012	2,965,682	587,690	3,972	872,663	4,430,007
Rritja e kapitalit të paguar	421,466	-	-	-	421,466
Ndryshime në rezervat e AFS	-	-	11,975	-	11,975
Tatime të shtyra mbi rezervat e AFS	-	-	(2,017)	-	(2,017)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	9,958	-	9,958
Humbja e vitit	-	-	-	(167,304)	(167,304)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	9,958	(167,304)	(157,346)
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	2,991	-	(2,991)	-
Balanca më datë 31 Dhjetor 2013	3,387,148	590,681	13,930	702,367	4,694,126

<i>Në EUR '000*</i>	Kapitali Aksioner	Rezerva Ligjore	Rezerva Përkthimi	Rezerva Rivlerësimi	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
Balanca më datë 1 Janar 2012	21,371	3,872	(324)	(18)	6,508	31,409
Ndryshime në rezervat e AFS	-	-	-	52	-	52
Tatime të shtyra mbi rezervat e AFS	-	-	-	(5)	-	(5)
Diferenca përkthimi	-	-	1	-	-	1
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	1	47	-	48
Fitimi i vitit	-	-	-	-	430	430
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	1	47	430	478
Diferenca përkthimi	-	361	(151)	-	(361)	(151)
Balanca më datë 31 Dhjetor 2012	21,371	4,233	(474)	29	6,578	31,736
Rritja e kapitalit të paguar	3,000	-	-	-	-	3,000
Ndryshime në rezervat e AFS	-	-	-	85	-	85
Tatime të shtyra mbi rezervat e AFS	-	-	-	(14)	-	(14)
Diferenca përkthimi	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	71	-	71
Humbja e vitit	-	-	-	-	(1,193)	(1,193)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	71	(1,193)	(1,122)
Diferenca përkthimi	-	21	(136)	-	(21)	(136)
Balanca më datë 31 Dhjetor 2013	21,371	4,254	(610)	100	5,364	33,479

The accompanying notes on pages 7 to 59 form an integral part of these financial statements.

* The EUR equivalent figures are provided for information purposes only and do not form part of the audited financial statements (refer to note 2.2).

Pasqyra e Fluksit të Parasë

Më datë 31 Dhjetor 2013

Shënime	Në LEK '000		Në EUR '000*		
	2013	2012	2013	2012	
Fluksi i parasë nga aktivitete operative					
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat		(178,731)62,684	(1,274)	449	
Regullimet për të rakorduar fitimin para tatimit mbi të ardhurat me fluksin neto të parasë nga aktivitetet operative					
Amortizimi i pronës dhe pajisjeve	9;11	220,660	247,696	1,574	1,782
Amortizimi i mjeteve të patrupëzuara	10	38,281	33,660	273	242
Tarifë zhvlerësimi për humbje kredie	7	780,435	585,634	5,567	4,213
Të ardhura nga interesat	21	(3,367,202)	(3,604,396)	(24,017)	(25,929)
Shpenzime për interesat	22	1,224,097	1,234,131	8,731	9,099
Fitim nga shitja e aktiveve	25	(6,485)	(2,127)	(46)	(15)
Shtesa / (kthim) i provigjoneve të tjera	19	3,984	(1,538)	28	(11)
Interesi i fituar		3,305,026	3,604,112	23,574	25,927
Interesi i paguar		(1,206,256)	(12,38,417)	(8,606)	(9,130)
Tatim fitimi i paguar		18,873	(7,061)	135	(51)
Fitimi operacional para ndryshimeve në aktivet dhe pasivet operative		832,411	914,378	5,939	6,576
Ndryshimet në aktivet dhe pasivet operative:					
Rritje në rezervat e detyrueshme		285,599	(166,016)	2,037	(1,194)
(Rritje) / zbritje në huatë dhe paradhëniet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare		(19,581)	256,759	(140)	1,847
Rritje / zbritje në huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve		(903,776)	451,909	(6,446)	3,251
Rritje në aktive të tjera		(277,471)	(126,369)	(1,979)	(909)
Rritje në detyrimet ndaj bankave		(409,896)	604,985	(2,924)	4,352
Zbritje në detyrimet ndaj klientëve		588,975	(123,821)	4,201	(891)
(Zbritje) / rritje në detyrime të tjera		(32,543)	(370,412)	(232)	(2,665)
Paraja neto e gatshme, e gjeneruar nga aktivitetet operative		63,718	1,441,413	456	10,367
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese					
Pagesa për blerjen e letrave me vlerë në dispozicion për shitje	8	(4,179,309)	(3,639,250)	28,558	26,071
Të hyrat nga shitja e letrave me vlerë në dispozicion për shitje	8	3,646,841	5,268,217	(26,410)	(37,741)
Të hyrat nga shitja e pronave dhe paisjeve		31,865	10,402	227	75
Blerja e pasurive të patrupëzuara	10	(45,691)	(37,244)	(326)	(268)
Blerja e pronave dhe paisjeve	9;11	(74,674)	(205,510)	(533)	(1,478)
Paraja neto (e përdorur në) nga aktivitetet operative		(620,968)	1,276,659	(4,430)	9,184
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese					
Rritje në borxhin e varur	18	6,143	7,212	44	52
Increase of capital		421,466	-	3,006	-
Shlyerje e fondeve të tjera të marra hua	7	(68,423)	(70,261)	(488)	(506)
Paraja neto nga aktivitetet investuese		359,186	(63,049)	2,562	(454)
Diferenca përkthimi		-	-	-2	2
Rritje / (Zbritje) në para dhe ekuivalentet e saj		(198,064)	2,655,023	(1,414)	19,099
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		6,787,857	4,132,834	48,847	29,748
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	29	6,589,793	6,787,857	47,433	48,847

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri 59 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

* Shifrat ekuivalente në Euro janë dhënë vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të audituara (shiko shënimin 2.2).

Shënime për pasqyrat financiare

Të vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Të gjithë shumatat janë shprehur në '000 Lekë, në rast se nuk specifikohet ndryshe)

1. Hyrje

Banka ProCredit Sh.a ("Banka"), fillimisht e njohur me emrin Banka FEFAD Sh.a., u themelua në Shkurt 1999 dhe në Mars të vitit 1999 mori licencën për të vepruar si një bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr. 8365, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 2 Korrik 1998, e zëvendësuar më pas me Ligjin Nr. 9662 datë 18 Dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit Nr. 8269, datë Dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë". Adresa zyrtare e bankës është "Rr. Dritan Hoxha, Kutia Postare 2395".

Më datë 31 Dhjetor 2013, aksioneri i bankës është ProCredit Holding AG & Co. KGaA që zotëron 100% të aksioneve:

Aksionerë	2013	2012
ProCredit Holding AG & Co. KGaA	100%	100%

Më datë 31 Dhjetor 2013, Banka operon me Drejtorinë e saj Qendrorë në Tiranë me 30 degë dhe agjenci në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Berat, Sarandë, Vlorë, Gjirokastr dhe Bilisht.

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti kryesor i Bankës është veprimtari bankare tregtare dhe retail brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka operon nëpërmjet licencës së plotë bankare të rishikuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë ("Banka e Shqipërisë" ose "BSH") që prej vitit 1999. Ajo merr pjesë në skemën shtetërore të sigurimit të depozitave, me shpalljen e Ligjit nr. 8873, datë 29 Mars 2002 "Mbi sigurimin e depozitave" ndryshuar në vazhdim me Ligjin 10106 datë 30 Mars 2009. Agjencia Shtetërore e Sigurimit të Depozitave garanton shlyerjen 100% të depozitave të individëve deri në 250 mijë Lekë për individ në rastin kur Banka e Shqipërisë merr përsipër administrimin e Bankës së siguruar dhe e shpall në faliment ose tërheq licencën ose kur banka detyrohet të shpallë falimentimin vullnetar.

2. Politika kryesore kontabël

2.1 Pasqyra e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare të ProCredit Bank sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e nxjerra nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtar (BSKN) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Financiar (IFRIC).

Standardet e mëposhtme, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë të detyrueshme për periudhën kontabël të Bankës duke filluar me ose pas datës së hyrjes në fuqi:

(a) Standarde të reja dhe të ndryshuara të miratuar nga Banka

Ndryshime tek Standardet Ndërkombëtare Kontabël 1 (SNK1), "Paraqitja e Pasqyrave Financiare (rishikuar në Qershor 2011, në fuqi për periudhë vjetore që fillon në ose pas datës 1 Korrik 2012),

ndryshon zbulimin e zërave të prezantuar tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë që subjektet të ndajnë zërat e paraqitur tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në dy grupe, bazuar në faktin nëse mund të riklasifikohen ose jo si fitim ose humbje në të ardhmen. Tiltulli i sugjeruar i përdorur nga SNK 1 ka ndryshuar në "Pasqyra e fitimit ose humbjeve dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse" dhe është aplikuar nga Banka pa ndikuar në matjen e transaksioneve dhe bilanceve.

ISNRF 7 (ndryshuar). Në Dhjetor 2011 BSNK lëshoi Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare – Ndryshimet tek SNRF 7. Ndryshimet sqarojnë kërkesat kontabël për instrumentet financiare dhe paraqesin kërkesat e reja të shënimeve shpjeguese të cilat synojnë të përmirësojnë krahasueshmërinë e instrumenteve financiare të përgatitura në përputhje me SNRF dhe US GAAP (Parimet e Kontabilitetit të Pranuara në Përgjithësi). Aplikimi i ndryshimit kërkohet për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2013. Pëvetësimi i standardit të ndryshuar nuk rezultoi në ndryshime domethënëse në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 13, Matja e Vlerës së Drejtë (rishikuar në Maj 2011, në fuqi për periudhat vjetore duke filluar në datë ose pas datës 1 Janar 2013), synon të përmirësojë dhe reduktojë kompleksitetin duke siguruar një përkufizim të saktë të vlerës së drejtë dhe një burim të vetëm të matjes së vlerës së drejtë dhe kërkesave të shënimeve shpjeguese për tu përdorur përgjatë SNRF.

Kërkesat të cilat kryesisht renditen midis SNRF dhe US GAAP, nuk e zmadhojnë përdorimin e kontabilitetit të vlerës së drejtë por ofrojnë udhëzime për mënyrën se si duhet aplikuar kur përdorimi i saj kërkohet ose lejohet nga standarde të tjera brenda SNRF. Përvetësimi i standardit të ri nuk rezultoi në ndryshime domethënëse në pasqyrat financiare të Bankës.

(b) Disa standarde dhe interpretime të reja janë krijuar të cilat janë të detyrueshme për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2013 ose me vone, por të cilat nuk janë relevante për operacionet e Bankës.

SNRF 10, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (të rishikuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore në datë ose pas datës 1 Janar 2013), zëvendësojnë të gjithë udhëzimin mbi kontrollin dhe konsolidimin e SNK 27 "Pasqyra financiare individuale dhe të konsoliduara; dhe SIC-12" Konsolidimi – njësitë ekonomike për qëllime të veçanta; SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit në mënyrë që të njëjtat kriteret të aplikohen për të gjitha njësitë ekonomike në përcaktimin e kontrollit. Ky përkufizim mbështetet nga udhëzimi i zgjeruar i aplikimit.

SNRF11, Marrëveshje të Përbashkëta, (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhën vjetore duke filluar në datë ose pas datës 1 Janar 2013), zëvendëson SNK 31 "Interesat në Sipërmarrje të Përbashkëta" dhe SIC-13 "Njësi Ekonomike të Kontrolluara së Bashku – Kontributet Jo-Monetare sipas Sipërmarrjeve". Ndryshimet në përkufizime kanë reduktuar numrin e "llojeve" të marrëveshjeve të përbashkëta në dy: operime të përbashkëta dhe sipërmarrje të përbashkëta. Zgjidhja e politikës ekzistuese e konsolidimit proporcional për njësitë ekonomike të kontrolluara së bashku është eliminuar. Kapitali neto është i detyrueshëm për pjesëmarrësit në sipërmarrje të përbashkëta.

SNRF 12, Shënime shpjeguese të interesit në njësi të tjera ekonomike, (të rishikuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar në datë ose pas datës 1 Janar 2013), i aplikohet njësitë ekonomike të cilat kanë interes në një filial, marrëveshje të për-

bashkët, një njësi partnere ose njësi me strukture të pakonsoliduar. Ajo zëvendëson kërkesat e shënimit shpjegues të paraqitura në SNK 28 “Investime në sipërmarrje”. SNRF 12 kërkon që njësitë ekonomike të zbulojnë atë informacion i cili ndihmon lexuesit e pasqyrave financiare që të vlerësojnë natyrën, rreziqet dhe efektet financiare të shoqëruara me interesat në filiale të njësisve ekonomike, partnere, marrëveshjeve të përbashkëta dhe njësisve ekonomike me struktura të pakonsoliduara. Për përmbushjen e këtyre objektivave, standardi i ri kërkon shënime shpjeguese në një sërë fushash, duke përfshirë gjykime të rëndësishme dhe supozime të bëra për përcaktimin nëse një njësi ekonomike kontrollon vetëm, kontrollon së bashku ose ndikon dukshëm në interesat e saj në njësi të tjera ekonomike, shënime shpjeguese të zgjeruara mbi aksionet e interesat jo kontrolluese në aktivitetet e grupit dhe fluksit të parase, informacionin financiar të përmbledhur të filialeve me interesa materiale jo-kontrolluese dhe shënime shpjeguese të detajuara të interesave në njësitë ekonomike me struktura të pakonsoliduara.

SNK 27 “Pasqyra Financiare te Ndara” (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2013) u ndryshua dhe qëllimi tani është të përshkruajë kërkesat e kontabilitetit dhe shënimeve shpjeguese për investime në filial, sipërmarrje të përbashkëta dhe partnere kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare të ndara. Udhëzuesi mbi kontrollin dhe pasqyrat financiare të konsoliduara u zëvendësua me SNRF 10 “Pasqyra Financiare të Konsoliduara”.

SNK 28 “Investime në Sipërmarrje Partnere dhe të Përbashkëta” (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudha vjetore në datë ose pas datës 1 Janar 2013). Ndryshimi i SNK 28 rezultoi nga projekti i Bordit në sipërmarrje të përbashkëta. Gjatë diskutimit për projektin, Bordi vendosi të përfshinte kontabilitetin për sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur metodën e kapitalit neto në SNK 28 meqënëse kjo metodë është e aplikueshme në sipërmarrjet e përbashkëta si dhe entitetet partnere. Me këtë përjashtim, udhëzimet e tjera nuk ndryshuan.

SNK 19 i ndryshuar “Përfitimet e Punonjësve” (rishikuar në Qershor 2011, dhe efektive për periudha vjetore në datë ose pas datës 1 Janar 2013) ndryshon në mënyrë domethënëse njohjen dhe matjen e shpenzimit të përfitimt të pensionit të përfutur dhe përfitimet e përfundimit, si dhe shënimeve shpjeguese për të gjitha përfitimet e punonjësve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në detyrimet neto të përcaktuara të përfitimt (aktive) kur ndodhin, si vijon: (i) kosto shërbimi dhe interes neto në fitimin ose humbjen; dhe (ii) rimatjet në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse. Banka raporton shumat e akumuluaru të këtyre rimatjeve në fitimin e pashpërndarë në kapitalin neto.

“Shënime shpjeguese – Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare” – Ndryshime në SNRF 7 (rishikuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudha vjetore duke filluar në datë ose pas datës 1 Janar 2013). Ndryshimi kërkon shënime shpjeguese që mundësojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të një entiteti të vlerësojnë ndikimin ose ndikimin potencial të marrëveshjeve, duke përfshirë të drejtat e kompensimit.

“Ndryshimet e Udhëzuesit të Ndryshimit të SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12” (rishikuar në Qershor 2012 dhe efektive për periudha vjetore duke filluar në datë ose pas datës 1 Janar 2013). Ndryshimet sqarojnë udhëzuesin e ndryshimit në SNRF 10 “Pasqyra Financiare të Konsoliduara”. Njësitë që adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojnë kontrollin ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën adoptohet SNRF 10, dhe nëse përfundimi i konsolidimit sipas SNRF 10 ndryshon nga SNK 27 dhe SIC 12, përsëritet periudha krahasuese e mëparshme (që është viti 2012) nëse nuk është e papraktikueshme.

Ndryshimet gjithashtu ofrojnë ndryshime shtesë në SNRF 10, SNRF 11 “Marrëveshje të Përbashkëta” dhe SNRF 12 “Zbulimi i Interesit në Subjekte të Tjera”, duke limituar kërkesat për të siguruar informacion krahasues të rregulluar vetëm për periudhën paraardhëse. Për më tepër, ndryshimet eliminojnë kërkesën për të paraqitur informacion krahasues për shënime shpjeguese lidhur me subjekte të strukturuara jo të konsoliduara për periudhat para aplikimit të SNRF 12.

(c) Deklarata të reja kontabël

Disa standarde dhe interpretime të reja kanë dalë që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat Banka nuk i ka adoptuar ende.

SNRF 9 “Instrumenta Financiare: Klasifikimi dhe Matja”. Të paret kyçe të standardit të rishikuar në Nëntor 2009 dhe ndryshuar në Tetor 2010, Dhjetor 2011 dhe Nëntor 2013 janë:

- Aktivitetet financiare kërkohej të klasifikohen në dy kategori matje: ato që maten me vlerën e drejtë dhe ato që maten me koston e amortizimit. Vendimi duhet marrë në njohjen fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të subjektit për administrimin e instrumentave të tij financiare dhe karakteristikat kontraktore të fluksit të parasë së instrumentit.

- Një instrument matet me koston e amortizimit vetëm nëse është instrument borxhi dhe të dyja (i) qëllimi i modelit të biznesit të subjektit është të mbajë aktivin për të mbledhur fluks para kontraktore, dhe (ii) flukset monetare kontraktore të aktivitetit përfaqësojnë vetëm pagesën e principalit dhe interesit (dmth, ka vetëm “tipare bazë kredie”). Të gjithë instrumentat e tjerë të borxhit duhen matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

- Të gjithë instrumentat e kapitalit neto duhen matur me vlerën e drejtë. Instrumentat e kapitalit që mbahen për tregti do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për instrumentat e tjerë të kapitalit, një përzgjedhje e parevokueshme mund të behet në njohjen fillestare, për të njohur fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë të realizuara ose jo nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse se sa fitimi ose humbja. Nuk duhet të ketë riciklim të fitimit ose humbjes se vlerës së drejtë në fitim ose humbje. Kjo përzgjedhje mund të bëhet instrument pas instrumenti. Dividentët duhen paraqitur në fitim ose humbje, përderisa përfaqësojnë një kthim në investim.

- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare vazhduan të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një subjekti do t'i kërkohej të prezantojë efektet e ndryshimeve në riskun e kredisë të detyrimeve financiare të hartuara në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

- Kërkesat kontabël mbrojtëse u ndryshuan për të qënë në linjë me administrimin e riskut. Standardi i ofron subjekteve një zgjedhje politike kontabël midis aplikimit të kërkesave kontabël mbrojtëse të SNRF 9 dhe vazhdimt të aplikimit të SNK 39 sepse standardi aktualisht nuk adreson kontablin në mbrojtje makro.

“Ndryshimet e bëra në SNRF 9 në Nëntor 2013 eliminuan datën efektive të detyrueshme, duke bërë në këtë mënyrë aplikimin vullnetar të standardit. Banka nuk synon të adoptojë versionin ekzistues të SNRF 9.

“Aktivet dhe Pasivet Financiare Kompensuese” – Ndryshime të SNK 32 (rishikuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudha vjetore që

fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2014). Ndryshimi i shtoi udhëzuesin e aplikimit SNK 32 për të adresuar mospërputhjet e identifikuar në aplikimin e disa kriterëve kompensues. Kjo përfshin sqarimin e shprehjes ‘aktualisht ka të drejtën ligjore të detyrueshme të kompensimit’ dhe që disa sisteme shlyerje bruto mund të konsiderohen ekuivalente me sistemet neto.

“Ndryshimet në SNRF10, SNRF 12 dhe SNK 27 – subjekte investimi” (rishikuar në 31 Tetor 2012 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në datë 1 Janar 2014). Ndryshimi paraqiste një përkufizim të subjektit investues si një subjekt që (i) merr fonde nga investitorët për qëllim tu sigurojë atyre shërbime menaxhimi të investimeve, (ii) angazhohet tek investuesit që qëllimi i biznesit është të investohen fonde vetëm për vlerësim kapitali ose të ardhura nga investimi dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e tij në bazë të vlerës së drejtë. Një subjekt investimi do t’i kërkohet të llogarisë filialet e tij në vlerë të drejtë nëpërmjet humbjes ose fitimit, dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime që lidhen me aktivitetet investuese të subjektit. SNRF 12 u ndryshua për të paraqitur shënime shpjeguese të reja, duke përfshirë gjykimet e rëndësishme të bëra gjatë përcaktimit nëse një subjekt është një subjekt investimi dhe informacion rreth mbështetjes financiare ose tjetër ndaj një filiali jo të konsoliduar, pavarësisht nëse planifikohet apo i është ofruar filialit.

IFRIC 21 – “Tarifat” (rishikuar në 20 Maj 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në datë 1 Janar 2014). Interpretimi qartëson për detyrimin për të paguar një tarifë që nuk është tatim mbi të ardhurat. Ngjarja detyruese që shkakton detyrimin është ngjarja e identifikuar nga legjislacioni që nxit detyrimin për të paguar tarifën. Fakti që një subjekt është ekonomikisht i detyruar të vazhdojë të operojë në të ardhmen, ose që përgatit pasqyrat financiare nën supozimin e shqetësimit të vazhdueshëm, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime njohje aplikohen në pasqyrat financiare afatshkurtra dhe ato vjetore. Aplikimi i interpretimit ndaj detyrimeve që lindin nga lëshimi i skemave tregtare është opsional.

ANdryshimet në SNK 36 – “Shënime shpjeguese për shumat e rikuperueshme në aktivet financiare” (rishikuar në Maj 2013 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë 1 Janar 2014; aplikimi para kësaj date lejohet nëse SNRF 13 aplikohet për të njëjtën periudhë kontabël të krahasueshme). Ndryshimet eliminojnë kërkesën për shënim shpjegues të shumës së rikuperueshme kur CGU ka dëshirën e mirë ose aktive të patrupëzuara me jetë të pacaktuar por që nuk ka patur zhvlerësim.

Ndryshimet në SNK 39 – “Zëvendësimet e Derivatave dhe Vazhdimi i Kontabilitetit Mbrojtës” (rishikuar në Qershor 2013 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë 1 Janar 2014). Ndryshimet do të lejojnë kontabilitetin mbrojtës të vazhdojë në një situatë ku një derivativ, i cili është krijuar si një instrument mbrojtës, zëvendësohet (dmth. Palët kanë rënë dakord të zëvendësojnë kundërpalën origjinale me një të re) të ndikojë rregullimin me një kundërpalë si rezultat i ligjeve ose rregulloreve, nëse përbushen kushte specifike.

Ndryshimet në SNK 19 – “Planet e caktuara të fitimit: Kontribute të punonjësve” (rishikuar në Nëntor 2013 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë 1 Korrik 2014). Ndryshimi i lejon subjekteve të njohin kontributet e punonjësve si reduktim në kostot e shërbimit në periudhën në të cilën kryhet shërbimi i punonjësve, në vend që të atribuohen kontributet në periudhat e shërbimit, nëse shumat e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit.

Përmirësime vjetore në SNRF 2012 (rishikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Ko-

rrik 2014, nëse nuk specifikohet ndryshe më poshtë). Përmirësimet konsistojnë në ndryshimet të shtatë standardet. SNRF 2 u ndryshua për të sqaruar përkufizimin e ‘gjendjes së kushtëzimit’ dhe për të përcaktuar të ndara ‘gjendjen e performancës’ dhe ‘gjendjen e shërbimit’; ndryshimi është efektive për transaksionet e pagesës së bazuar në aksione për të cilat data e marrjes është më ose pas datës 1 Korrik 2014.

SNRF 3 u ndryshua për të sqaruar që (1) një detyrim për të kushtuar konsiderate të paparashikuar që përputhet me përkufizimin e një instrumenti financiar klasifikohet si një detyrim financiar ose kapital, në bazë të përkufizimeve në SNK 32, dhe (2) konsiderata për kontigjentin jo kapital, financiar ose jo, matet me vlerë të drejtë në datën e raportimit, me ndryshime në vlerën e drejtë të njohur në fitim dhe humbje. Ndryshime në SNRF 3 janë efektive për kombinime biznesi ku data e blerjes është më ose pas datës 1 Korrik

SNRF 8 u ndryshua për të kërkuar (1) shënime shpjeguese të gjykimeve të bëra nga menaxhimi në bashkimin e segmenteve operuese, duke përfshirë një përshkrim të segmenteve të cilat janë bashkuar dhe treguesit ekonomik të cilët janë vlerësuar gjatë përcaktimit që segmentet e bashkuara kanë karakteristika ekonomike të ngjashme, dhe (2) rikoncilimin e aktiveve të segmentit në aktivet e subjektit kur raportohen aktivet e segmentit.

Baza për përfundimet të SNRF IFRS 13 u ndryshua për të sqaruar që fshirja e disa paragrafeve në SNK 39 me publikimin e SNRF 13 nuk u bë me qëllim për të fshirë aftësinë e matjes së arkëtimeve afatshkurtra dhe pagimet me fature ku ndikimi i uljes së çmimit është i parëndësishëm.

SNK 16 dhe SNK 38 u ndryshuan për të sqaruar mënyrë si shumat e mbartur bruto dhe zhvlerësimi i akumuluar trajtohen kur subjekti përdor modelin e rivlerësimit.

SNK 24 u ndryshua për të përfshirë, si palë e lidhur, një subjekt që ofron shërbime kryesore të stafit menaxherial ndaj subjektit raportues ose kompanisë mëmë të subjektit raportues (“subjekti menaxhues”), dhe për të kërkuar shënime shpjeguese për shumat e tarifuara ndaj subjektit raportues nga subjekti menaxhues për shërbimet e ofruara.

Annual Improvements to IFRSs 2013 (issued in December 2013 and effective for annual periods beginning on or after 1 July 2014). The improvements consist of changes to four standards.

The basis for conclusions on IFRS 1 is amended to clarify that, where a new version of a standard is not yet mandatory but is available for early adoption; a first-time adopter can use either the old or the new version, provided the same standard is applied in all periods presented.

Përmirësimet vjetore në SNRF 2013 (rishikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 korrik 2014). Përmirësimet konsistojnë në ndryshime të katër standardeve.

Baza për përfundimet në SNRF 1 është ndryshuar për të sqaruar që, kur një version i ri i standardit nuk është ende i detyrueshëm por është i disponueshëm për adoptim të hershëm; një adoptim për herë të parë mund të përdorë versionin e vjetër ose të ri, me kusht që të aplikohet i njëjti standard në të gjitha periudhat e paraqitura.

SNRF 3 u ndryshua për të sqaruar që ai nuk përdor kontabilitetin për formimin e një marrëveshje të përbashkët nën SNRF IFRS 11. Ndryshimi gjithashtu sqaron që qëllimi i përjashtimit aplikohet vetëm në pasqyrat financiare të vetë marrëveshjes së përbashkët.

Ndryshimi i SNRF 13 sqaron që portofoli i përjashtimit në SNRF 13,

i cili lejon një subjekt të masë vlerën e drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe detyrime financiare neto, aplikohet në të gjitha kontratat (përfshirë kontratat për të blerë ose shitur artikuj jo financiarë) që janë brenda qëllimit të SNK 39 ose SNRF 9.

SNK 40 u ndryshua për të sqaruar që SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë njësoj ekskluzive. Udhëzuesi në SNK 40 ndihmon përgatitësit të dallojnë midis pronës së investimit dhe pronës së okupuar të pronarit. Përgatitësit gjithashtu duhet t'i referohen udhëzuesit në SNRF 3 për të përcaktuar nëse blerja e një prone investimi është një kombinim biznesi.

SNRF 14, llogaritë e shtyra rregullatore (rishikuar në Janar 2014 dhe efektive për periudha vjetore që fillojnë në datë ose pas datës 1 Janar 2016). SNRF 14 lejon adoptuesit për herë të parë të vazhdojnë të njohin shumat e lidhura me rregulloren e normës në përputhje me kërkesat e mëparshme të GAAP kur adoptojnë SNRF. Megjithatë, për të përmirësuar krahasueshmërinë me subjektet që aplikojnë tashmë SNRF dhe që nuk njohin këto shuma, standardi kërkon që efekti i rregullores së normës të paraqitet i ndarë nga artikujt e tjerë. Një subjekt që paraqet pasqyrat financiare SNRF nuk lejohet të aplikojë standardin.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare paraqiten në Lekun shqiptar, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt. Ato përgatiten nën marrëveshjen e kostos historike, siç modifikohen nga njohja fillestare e instrumentave financiare të bazuar në vlerën e drejtë dhe nëpërmjet rivlerësimit të aktiveve financiare të gatshme për shitje.

Shifrat ekuivalente në Euro

IPërveç paraqitjes së pasqyrave financiare në Lek, është përgatitur dhe një informacion suplementar në Euro për përdoruesit e pasqyrave financiare, duke e përkthyer/këmbyer Lek'000 në Euro'000. Pasqyra e gjendjes financiare dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë përkthyer në normën zyrtare të Bankës së Shqipërisë më datë 31 Dhjetor 2013 140.20 Lekë në 1 Euro (2012: 139.59). Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyra e fluksit të parasë është këmbyer me normën mesatare të këmbimit për vitin 2013 me 140.27 Lekë në 1 Euro (2012: 139.01).

Politikat kryesore kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk deklarohen ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF i kërkon menaxhimit që të formulojë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe pasiveve, të ardhurat dhe shpenzimet. Vlerësimet dhe supozimet në sipërmarrje bazohen në eksperiencën historike dhe në faktorë të tjerë të ndryshëm të cilat besohen se janë të arsyeshme në këto rrethana, rezultatet e të cilave formojnë bazën e formulimit të gjykimeve mbi vlerën e mbartur të aktiveve dhe pasive të cilat nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto përlllogaritje të përafërta.

Përlllogaritjet e përafërta dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Përsëritjet për parashikimet kontabël njihen në periudhën në të cilën është rishikuar parashikimi nëse përsëritja prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e përsëritjes dhe periudhave të ardhshme nëse përsëritja prek periudhën aktuale dhe të ardhshme.

Gjykimet e bëra nga menaxhimi në aplikimin e SNRF të cilat kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një risk të rëndësishëm të rregullimit material në vitin tjetër diskutohen në shënimin 4.

2.3 Instrumentat Financiare

(i) Klasifikimi

Banka i klasifikon aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: hua dhe të arkëtueshme dhe aktive financiare të gatshme për shitje. Menaxhimi përcakton klasifikimin e investimeve të saj me njohje fillestare. Banka nuk klasifikoi asnjë aktiv financiar në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes gjatë periudhës raportuese.

Hua dhe të arkëtueshme

Huatë dhe të arkëtueshme janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara të cilat nuk kuotohen në një treg aktiv. Të gjitha huatë dhe paradhëniet njihen fillimisht në vlerën e drejtë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet njihen kur arkëtimi i sugjerohet huamarrësit. Pas njohjes fillestare, këto maten rrjedhimisht me kostot e amortizuara duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv. Kosto e amortizuar përlllogaritet duke marrë parasysh çdo kosto të nxjerrë dhe çdo skonto ose prim në marrëveshje.

Aktive financiare të gatshme për shitje

Investimet të gatshme për shitje janë ato investime të cilat synohen të mbahen për një periudhë të pacaktuar kohore, e cila mund të shitet në përgjigje të nevojave për likuiditet ose ndryshimeve në norma interesit, të kursit të këmbimit ose çmimeve të kapitalit neto.

(ii) Matja

Aktivtë financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë plus kostot e transaksionit për të gjitha aktivtë financiare të mbartura jo në vlerën e tyre të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Aktivtë financiare të gatshme për shitje mbarten si rrjedhim në vlerën e tyre të drejtë. Huatë dhe interesat e arkëtueshme mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Matja sipas koston aplikohet vetëm për investimet në instrumenta të kapitalit neto të cilat nuk kanë një çmim tregu të kuotuar dhe vlera e drejtë e së cilës nuk mund të matet me siguri dhe derivatet që lidhen me të dhe duhet të përcaktohen me dorëzimin e këtyre instrumentave kapitali të pakuotuar (shënim 8).

(iii) Parimet e matjes së Vlerës së Drejtë

Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar në tregjet aktive bazohen në çmimet e ofertave aktuale. Kur tregu për një mjet financiar nuk është aktiv (dhe për letra me vlerë të palistuar), Banka përcakton vlerën e drejtë nëpërmjet përdorimit të teknikave të vlerësimit, gjërësisht të përdorura nga pjesëmarrësit e tregjeve.

Në rastin kur përdoren teknika të fluksit të skontuar të parasë, fluksi në kohë i parasë bazohet në vlerësimet më të mira të menaxhimit dhe norma e skontimit është normë e lidhur me tregun në datën e raportimit për një instrument me afate dhe kushte të ngjashme. Në rastin kur përdoren modele çmimesh, inputet bazohen në matjet e tregut në datën e raportimit.

(iv) Fitime dhe humbje të gjeneruara nga matje të mëtejshme

Fitimet dhe humbjet e gjeneruara nga ndryshimet në vlerën e drejtë të mjeteve financiare të gatshme për shitje njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, deri kur aktivtë financiare nuk njihen ose zhvlerësohen. Në këtë kohë, fitimi ose humbja e grumbulluar e njohur më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihet në

zërin e fitimit ose humbjes. Megjithatë, interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv, fitimet në valute dhe humbjet në aktive monetare të klasifikuara si të gatshme për tu shitur njihet në zërin e fitimit ose humbjes.

(v) Arka dhe ekuivalentet e saj

Arka dhe ekuivalentet e saj përbëhen nga gjendja e arkës dhe depozitat me maturim origjinal prej 3 muajsh ose me pak. Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore nuk është e disponueshme për operacionet e përditshme të Bankës dhe nuk përfshihet si përbërës i arkës dhe i ekuivalenteve të saj për efekt të pasqyrës së fluksit të parasë. Arka dhe ekuivalentet e saj mbarten me koston e amortizuar. Detaje të mëtejshme të përbërësve të arkës dhe ekuivalenteve të saj gjenden në shënimin 29.

(vi) Mosnjohje

Aktivet financiare nuk njihen kur e drejta kontraktuale për të arketuar fluks parash nga këto aktive pushon së ekzistuari ose kur aktivet janë transferuar dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e zotërimit të aktiveve gjithashtu janë transferuar (d.m.th. nëse kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet nuk janë transferuar, testet e kontrollit të Bankës për të garantuar këtë përfshirje në vazhdim mbi bazën e çdo pushteti të mbajtur të kontrollit nuk ndalon çregjistrimin). Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shlyhen ose në rastin e kundërt fshihen.

(vii) Financiar garanties

Kontratat e garancive financiare janë kontrata të cilat kërkojnë nga emetuesi kryerjen e pagesave të veçanta për të rimbursuar mbajtësin e kësaj garancie për një humbje që ka pësuar për shkak se një debitor i caktuar nuk ka shlyer këstin në datën e caktuar, në përputhje me afatet e një instrumenti huaje.

Këto garanci financiare i jepën bankave, institucioneve financiare dhe organeve të tjera në emër të klientëve për të siguruar kreditë, paradhëniet bankare dhe të tjera shërbime bankare. Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare në vlerë të drejtë në datën e garancisë së dhënë. Në ndjekje të njohjes fillestare, detyrimet bankare nën këto garanci maten në nivelin më të lartë të matjes fillestare, minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitime ose humbje tarifën e të ardhurave të fituara mbi bazën e një linje të drejtë mbi jetën e garancisë dhe vlerësimin më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të zgjidhur çdo detyrim financiar të ngritur në datën e raportimit. Këto vlerësime përcaktohen bazuar në eksperiencën e transaksioneve të ngjashme dhe historikut të humbjeve në të shkuarën, shoqëruar me gjykimin e Menaxhimit.

Çdo rritje në detyrime që ka lidhje me garancitë shënohet tek fitime ose humbje nën zërin e shpenzimeve të tjera operative.

2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbartura me koston e amortizuar

Banka vlerëson në çdo datë të mbajtjes së pasqyrës së pozicionit financiar nëse ka prova objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare të zhvlerësohet. Një aktiv financiar ose një grup aktiveve financiare zhvlerësohet dhe humbjet nga zhvlerësimi arrihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve të cilat kanë ndodhur pas regjistrimit të parë të aktivitetit ("një ngjarje humbjeje") dhe kjo ngjarje (ose ngjarjet) ka një ndikim mbi fluksin e pritshëm të parave në aktive financiare ose në grupin e aktiveve financiare e cila mund të parashikohet në varësi.

Kriteret që Banka përdor për përcaktimin e provave objektive të një humbje nga zhvlerësimi përfshijnë:

- Shkelje të shlyerjeve kontraktuale të principalit ose interesit;
- Vështirësitë që huamarrësi përjeton në fluksin e parasë (për shembull, norma e kapitalit neto, përqindja e të ardhurave neto të shitjeve);
- Shkelje e kontratës ose kushteve të kredisë;
- Inicimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësim i pozicionit konkurrues të huamarrësit;
- Përkeqësim në vlerën e kolateralit; dhe
- Ulja në nivelin e klasifikimit të investimit.

Banka vlerëson fillimisht nëse prova objektive e zhvlerësimit ekziston veçant për aktivet financiare të cilat janë të rëndësishme më vete dhe e ndarë ose së bashku për aktivet financiare që nuk janë të rëndësishme më vete. Nëse Banka vendos se nuk ekziston asnjë provë objektive e zhvlerësimit për një aktiv financiar të vlerësuar më vete, qoftë kjo e rëndësishme ose jo, ajo i përfshin aktivet në një grup të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë dhe i vlerëson ato së bashku për zhvlerësim.

Aktivet të cilat vlerësohen më vete për zhvlerësim dhe për të cilët një humbje zhvlerësimi është ose vazhdon të njihet/regjistrohet nuk përfshihen në një vlerësim të përbashkët për zhvlerësim.

Shuma e humbjes matet si diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të fluksit të pritshëm të parashikuar të parasë (duke përfshirur humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur) të skontuara në normën origjinale të interesit efektiv të aktiveve financiare. Vlera e mbartur e aktiveve zbritet nëpërmjet përdorimit të një llogarie depozite dhe vlera e humbjes njihet/regjistrohet në fitim ose humbje.

Përlllogaritja e vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të vlerësuar të një aktiviteti financiar të kolateralizuar pasqyron fluksin e parasë i cili mund të rezultojë nga sekuestrimi minus koston për sigurimin dhe shitjen e kolateralit në rastet kur është ose jo i mundur sekuestrimi.

Duke pasur për qëllim vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të kredisë (dmth mbi bazën e procesit të klasifikimit të Bankës e cila merr në konsideratë llojin e aktiveve, industrinë, vendndodhjen gjeografike, statusin e afatit të kaluar dhe faktorë të tjerë përkatës). Këto karakteristika i përkasin vlerësimit të fluksit në të ardhmen të parasë për grupet e këtyre aktiveve duke u bërë tregues i aftësisë së huamarrësit për të paguar të gjitha shumatat në datat e caktuara në përputhje me afatet kontraktuale të aktiveve që po vlerësohen.

Flukset e parasë në të ardhmen të një grup aktiveve financiare të cilat vlerësohen së bashku për zhvlerësim vlerësohen në bazë të fluksit kontraktual të parasë të aktiveve në Bankë dhe nga eksperiencia historike e humbjeve për aktivet me karakteristika të riskut të kredisë të ngjashme me ato të Bankës. Eksperiencia historike e humbjes rregullohet mbi bazën e të dhënave aktuale të vëzhguara për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk prekin periudhën në të cilën bazohet eksperiencia historike e humbjes dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike të cilat aktualisht nuk ekzistojnë.

Parashikimet e ndryshimeve në fluksin e parasë në të ardhmen për grupet e aktiveve duhet të pasqyrojnë dhe të jenë në harmoni të drejtpërdrejtë me ndryshimet në të dhënat e lidhura të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronësisë, statusin e pagesës ose të faktorëve të tjerë tregues të ndryshimeve në probabilitetin

e humbjeve në Bankë dhe rëndësisë së tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e vlerësuar në të ardhmen të parasë rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe ekperiences aktuale të humbjes.

Kur një hua është e pa arketueshme, ajo konsiderohet e fshirë ndaj provigjoneve të lidhura për zhvlerësim kredie. Këto kredi konsiderohen të fshira pasi të jenë përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme dhe të jetë përcaktuar vlera e humbjes.

Nëse në një periudhë pasuese, vlera e humbjes nga zhvlerësimi bie dhe rënia mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje e cila ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (si psh një përmirësim në normën e kredisë të huamarrësit), humbja e mëparshme nga zhvlerësimi i njohur/regjistruar kthehet nëpërmjet rregullimit të llogarisë e zhvlerësimit/zbritjes. Shuma e kthyer njihet në fitim ose humbje në tarifën e zhvlerësimit për humbjet në kredi. Shlyerjet e kredive të fshira më parë njihen në të ardhura të tjera operative.

2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbartura në vlerë të drejtë

Aktive financiare të gatshme për shitje

Banka vlerëson në çdo datë të paraqitjes së pasqyrës së pozicionit financiar nëse ka prova objektive se një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare është zhvlerësuar. Në rastin e letrave me vlerë kapitale të klasifikuara si të gatshme për shitje, një rënie e dukshme ose e zgjatur në vlerë të drejtë e letrës me vlerë nën koston e saj merret parasysh në përcaktimin nëse aktivet janë zhvlerësuar ose jo.

Nëse ndonjë prej këtyre evidencave ekziston për aktive financiare të gatshme për shitje, humbja kumulative – e matur si diferencë midis koston së blerjes dhe vlerës aktuale të drejtë, minus çdo humbje zhvlerësimi mbi këtë aktiv financiar të njohur në fitime ose humbje – reflektohet nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi të klasifikuar si të gatshme për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në fitim ose humbje të humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi reflektohet në llogaritë e fitimit ose humbjes.

2.6 Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë ligjore në fuqi për të kompensuar shumën e njohur dhe ka një synim për të vendosur një bazë neto, ose për të realizuar aktivet dhe zgjidhur detyrimin në mënyrë simultane.

2.7 Prona dhe pajisje

Zërat e pronës, ndërtesës dhe pajisjes, deklarohen në kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën e mbartur të aktiveve ose njihen si një aktiv individual, sipas nevojës, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen të shoqeruara me zërin do të rrjedhin tek Banka dhe kosto e zërit mund të matet në varësi. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i tarifohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato janë shkaktuar.

Zhvlerësimi tarifohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes mbi bazën e një linje të drejtë mbi jetët e dobishme të vlerësuar për çdo pjesë të një zeri të pronës dhe pajisjes për të shpërndarë kostot e tyre në vlerën e tyre të mbetur. Përmirësimet për Qiradhënie i përkasin shpenzimeve të rinovimeve të degëve dhe zhvlerësohen gjatë periudhës të qiradhënies. Vlerat më poshtë janë vlerësime të përafërta të normave vjetore të përdorura:

	%
i. Kompjuter, pajisje elektronike dhe pjesje të tjera	20
ii. Makina	20
iii. Mobilje	10
iv. Ndërtesa	2.5

Vlera e mbetur dhe jetët e dobishme rivlerësohen çdo vit.

2.8 Aktive të patrupëzuara

Aktivitet e patrupëzuara të blera nga Banka shprehen në kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Amortizimi i tarifohet llogarisë së fitimit ose humbjes mbi bazën e një vije të drejtë me një normë vjetore prej 10% mbi jetët e dobishme të parashikuara të aktiveve të patrupëzuara.

2.9 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Aktivitet të cilat i nënshtrohen amortizimit dhe zhvlerësimit rishikohen për zhvlerësim kurdoherë kur ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera e mbartur nuk mund të jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për atë vlerë në të cilën vlera e mbartur e aktiveve e tejkalon vlerën e saj të rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë e një vlere të drejtë të aktivitetit minus kostot për të shitur dhe vlerës në përdorim. Me qëllim vlerësimin e zhvlerësimit, aktivet grupohen në nivelet e tyre më të ulëta për të cilat ato janë flukse parash individualisht të identifikueshme (njësi gjeneruese të parasë).

2.10 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e atribuara të transaksionit. Në vijim të njohjes fillestare, huamarrjet shprehen në kosto të amortizuara me një diferencë midis koston dhe vlerës së riblerjes e cila njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektive.

2.11 Prona investimi

Prona investimi është prona e mbajtur nga banka për të fituar të ardhura qiraje ose për vlerësim kapitali, ose të dyja dhe që nuk zotërohet nga Grupi. Prona investimi përfshin aktive nën ndërtim për përdorim të ardhshëm si pronë investimi.

Prona investimi fillimisht njihet si kosto, duke përfshirë koston e transaksionit dhe në vijim rimatet me vlerën e drejtë të përditësuar për të pasqyruar kushtet e tregut në fund të periudhës raportuese. Vlera e drejtë e pronës së investimit është çmimi që do të merret nga shitja e një aktivi në transaksion sistematik, pa zbritur kostot e transaksionit. Vlera e drejtë e pronës së investimit përcaktohet bazuar në raportet e vlerësuesve të pavarur, të cilët kanë një kualifikim profesional të njohur dhe të rëndësishëm dhe të cilët kanë eksperiencë në vlerësimin e pronës së kategorisë dhe vendndodhjes së ngjashme.

Të ardhurat e qirasë regjistrohen në fitim ose humbje për vitin

brenda të ardhurave të tjera operative. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të pronës së investimit regjistrohen në humbje ose fitim të vitit dhe paraqiten të ndara.

2.12 Qiradhënie

Qiradhëniet ku një pjesë e konsiderueshme e risqeve dhe shpërblyemeve të pronarëve mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qiradhënie operative.

Qiradhëniet e regjistruara nga Banka janë kryesisht qiradhënie operative. Pagesat gjithsej të kryera nën zërin e qiradhënies operative i tarifohen shpenzimeve të tjera operative në fitim ose humbje mbi bazën e një linje të drejtë gjatë periudhës së qiradhënies.

2.13 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentat financiare mbartëse të interesit njihen brenda 'të ardhurave nga interesi' dhe 'shpenzimeve nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose të një detyrimi financiar dhe të shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose të shpenzimeve nga interesi gjatë periudhave përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skanton saktësisht pagesat ose faturat e parave të parashikuara në të ardhmen nëpërmjet jetëgjatësisë të instrumentit financiar ose, kur nevojitet një periudhë më e shkurtër e vlerës së mbartur neto të aktivit financiar ose të detyrimit financiar. Në llogaritjen e normës së interesit efektiv, Banka vlerëson fluksin e parasë duke konsideruar të gjitha afatet kontraktuale të instrumentave financiare por nuk konsideron humbjet në të ardhmen të kredisë. Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat ose pikat e paguara ose të arkëtuara midis palëve në kontratë të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv, kostove të transaksionit dhe të gjitha primeve ose skontimeve të tjera.

Vetëm pasi një aktiv financiar ose një grup i aktiveve të ngjashme financiare të jetë hequr si rezultat i një humbje nga zhvlerësimi, njihet e ardhura nga interesi nëpërmjet përdorimit të normës së interesit të përdorur për të skontuar fluksin e parasë në të ardhmen me qëllim matjen e humbjes nga zhvlerësimi.

2.14 Të ardhura nga Tarifatat dhe komisionet

Tarifatat dhe komisionet njihen në përgjithësi mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara kur sigurohet shërbimi. Tarifatat e angazhimit të kredisë për kredi të cilat priten të konsumohen, shtyhen (së bashku me kostot e lidhura direkte) dhe njihen si një rregullim i normës së interesit efektiv mbi kredinë.

2.15 Provigjonet

Provigjonet me pretendime ligjore njihen: kur Banka ka një detyrim ligjor aktual ose praktik, si pasojë e një ngjarjeje të kaluar; ka më tepër të ngjarë që të ndodhë një humbje materiale në lidhje me shlyerjen e detyrimit; dhe se shuma është vlerësuar drejt.

Në rastin kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e një humbje që do të kërkohet që të përcaktohet duke konsideruar klasën e detyrimeve si një e tërë. Një provigjon njihet edhe nëse mundësia e një humbje përsa i përket një zëri të përfshirë në të njëjtën klasë të detyrimeve është e vogël.

Provigjonet maten në vlerën aktuale të shpenzimeve që priten të kërkohen për të rregulluar detyrimet nëpërmjet përdorimit të një norme para tatimore e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqet specifike ndaj detyrimeve. Rritja në provigjone për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim për interesa.

2.16 Përfitimet e punonjësit

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve

Banka realizon vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat i mundësojnë punonjësit përfitimet e pensionit. Shteti shqiptar është përgjegjës për sigurimin ligjor të planit minimal të kontributeve të pensioneve në Shqipëri sipas nje plani të përcaktuar të kontributeve për pension. Kontributet e Bankës për planin e përfitimit të pensionit i tarifohen humbjes ose fitimit siç ndodh.

Lejet vjetore të paguara

Banka njih si detyrim shumë e skontuar të kostove të parashikuara të lidhura me lejet vjetore të pritura për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

2.17 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat në llogarinë fitim ose humbje për vitin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Tatim mbi të ardhurat njihet në fitim ose humbje me përjashtim të masës kur ajo lidhet me zërat e njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në rastin e së cilës ajo njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për tu paguar në të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimit të miratuara ose të miratuara kryesisht në datën e raportimit dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë paraqitet duke përdorur metodën e detyrimit, duke dhënë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerën e përdorur për qëllime tatimore. Vlera e tatimit të shtyrë të dhënë bazohet në mënyrën e pritshmërisë të realizimit ose përcaktimit të vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose kryesisht të miratuara në datën e raportimit dhe priten të aplikohen kur aktivet e lidhura e tatimit të shtyrë mbi të ardhurat realizohen ose detyrimi i tatimit të shtyrë mbi të ardhurat të shlyhet. Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet vetëm në masën e mundshme kur fitimet e tatueshme në të ardhmen të jenë të disponueshme kundrejt aktiveve që mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyre pakësohen në masën kur përfitimet e lidhura me tatimin nuk janë më të mundura që të realizohen.

2.19 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes e Bankës.

(ii) Transaksionet dhe bilancet

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhë funksionale nëpërmjet përdorimit të normës së këmbimit e cila mbisundon në datat e transaksioneve dhe njihet në llogarinë e fitimit ose humbjes nën zërin "Fitim minus humbje nga transaksionet në monedhë të huaj".

(iii) Përkthime dhe bilance

Aktivet dhe pasivet monetare të emërtuara në monedhë të huaj ripërkthehen sipas kursit të këmbimit të monedhës funksionale e cila sundon në datën e raportimit. Të gjitha diferencat njihen në zërin 'Fitim minus humbje nga transaksionet në monedhë të huaj' në llogarinë e fitimit ose humbjes. Zërat jo monetare të cilat maten me koston historike në një monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit të datave të transaksioneve fillestare. Zërat jo monetare të cilat maten me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë.

Normat e aplikueshme të këmbimit (Lek kundrejt njësisë valutore) për monedhat kryesore më datë 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	2013	2012
USD	101.86	105.85
EUR	140.20	139.59
GBP	168.39	171.18
CHF	114.41	115.65

2.20 Informacioni krahasues

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat kryesore kontabël të Bankës. Kur ka qënë e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për qëllime krahasimi.

3. Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë në një shumëllojshmëri risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e disa niveleve të riskut ose kombinimit të riskut. Ndërmarrja e riskut është themelore për biznesin financiar dhe risqet operative janë një pasojë e pashmangshme në ekzistencën e një biznesi.

Objekti i Bankës është arritja në këtë mënyrë e një ekuilibri të duhur midis riskut dhe kthimit dhe minimizimit të efekteve potenciale të kundërta në performancën financiare të Bankës.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës hartohen për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të përcaktuar limite dhe kontrolle të duhura të riskut dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve nëpërmjet instrumenteve të sistemeve të besueshme dhe koherente të informacionit. Banka rregullisht rishikon politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në treg, produktet dhe praktikat më të mira të shfaqura. Menaxhimi i riskut zbatohet nëpërmjet divizionit të riskut të Bankës sipas politikave të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi siguron parime me shkrim për menaxhimin e përgjithshëm të riskut si edhe për politikat me shkrim që mbulojnë zona të veçanta, si për shembull risku i kredisë, risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit dhe risku i likuiditetit.

Llojet më të rëndësishme të riskut janë risku i kredisë, risku i likuiditetit, risku i tregut dhe risqe të tjera operationale. Risku i tregut përfshin riskun e monedhës, normën e interesit dhe risqe të tjera të çmimit.

3.1 Risku i monedhës

Banka ekspozohet ndaj riskut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Risku i monedhës është risku i luhatjes së vlerës së instrumentave financiare si rezultat i ndryshimeve në

normat e kursit të këmbimit.

Banka përpiket të menaxhojë këtë risk nëpërmjet mbylljes së pozicioneve ditore të hapjes së monedhës së huaj dhe nëpërmjet përcaktimit dhe monitorimit të limiteve në pozicionin e hapjes dhe gjithashtu garantimin që këto pozicione të mbeten në përputhje me udhëzimet e Bankës së Shqipërisë.

Ekspozimet e transaksioneve të Bankës i japin shtysë fitimeve dhe humbjeve në monedhë të huaj të cilat njihen në llogarinë e fitimit ose humbjes. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare dhe jo monetare të Bankës.

Nën vendimet e Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve të Bankës dhe miratimit të Komitetit të Menaxhimit të Riskut të Grupit, një pozicion strategjik mund të shënohet në nivel bankë në mënyrë që të mbrojë risqet e grupit.

Rregullat e mëposhtme aplikohen në nivel bankë:

- Monedha me të cilën Banka siguron financim përcakton monedhën me të cilën kreditë u jepen klienteve dhe anasjelltas. Kërkohej që të balancohen aktivet dhe detyrimet për monedhë në të dyja vlerat dhe maturimet sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë që të mbrojnë bankën ndaj luhatjeve të monedhës. Nëse kjo nuk është e mundur, instrumentat financiarë duhet të përdoren në atë masë sa për të mbyllur boshllëqet.
- Nëse banka kryen veprime si në monedhën vendase dhe në monedha të tjera, ajo duhet të monitorojë ekspozimet në monedhë të huaj në një bazë ditore (njësia e thesarit dhe kontrolli financiar) me qëllim mbylljen e çdo pozicioni të hapur (me përjashtim të pozicioneve strategjike).

Krijimi i pozicioneve në monedhë të huaj për qëllime spekulative nuk lejohet. Levizjet në monedhë dhe goditjet nga normat e kursit të këmbimit analizohen nëpërmjet analizave të skenareve. Analizat e skenareve vlerësojnë efektin që kanë lëvizjet e normave të këmbimit në Pozicionin e Hapur të Monedhës (PHM) në çdo monedhë materiale operuese

Njësia e thesarit e Bankës informon rregullisht departamentin e menaxhimit të riskut të bankës dhe në rastet e zhvillimeve të rëndësishme të normës së këmbimit.

Njësia e thesarit të bankës monitoron PHM në mënyrë të vazhdueshme gjatë ditës dhe është përgjegjëse për mbylljen brenda periudhës së duhur kohore. Kjo PHM rishikohet nga kontrolli financiar i bankës dhe raportohet çdo ditë tek PCH departamenti MIS/ i kontrollit. Njësia e Kontrollit financiar të bankës dhe njësia e kontabilitetit koordinojnë në mënyrë të rregullt PHM e tyre me PHM e njësive të thesarit, të paktën një herë në muaj. Në rast të identifikimit të një devijimi mbi 1% të kapitalit rregullator, kontrolli financiar është i detyruar që të informojë anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive përgjegjës të njësive të thesarit.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përfshira ose jo në bilanc si më datë 31 Dhjetor 2013 me monedhën e huaj me të cilën ato u emërtuan ishin si më poshtë:

31 Dhjetor 2013	ALL	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktive					
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	3,409,975	4,646,804	680,370	78,672	8,815,821
Kredi dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	-	213,950	330,663	-	544,613
Instrumenta financiare të gatshme për shitje	4,149,999	842,867	-	-	4,992,866
Hua dhe paradhënie për klientët	13,114,632	9,260,481	614,762	-	22,989,875
Aktive të tjera financiare	178,517	226,733	46,296	3,873	455,419
Totali i Aktiveve Financiare	20,853,123	15,190,835	1,672,091	82,545	37,798,594
Detyrime					
Ndaj bankave	744,751	-	14,544	-	759,295
Ndaj klientëve	20,751,575	9,719,967	1,888,286	82,278	32,442,106
Fonde të tjera të marra hua	-	910,261	-	-	910,261
Detyrime të tjera financiare	134,795	70,545	3,614	77	209,029
Borxh i varur	-	1,308,029	-	-	1,308,029
Totali i detyrimeve Financiare	21,631,121	12,008,802	1,906,444	82,355	35,628,722
Pozicioni neto i monedhës në bilanc	(777,997)	3,182,033	(234,353)	190	2,169,873
Angazhime dhe garant jashtë bilancit	1,186,671	912,120	626,119	-	2,724,910

Banka merr parasysh faktin që kapitali i saj neto të emërtohet në Euro kur ajo kryen rishikimin e PHM të saj në Euro.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve financiare brenda dhe jashtë bilancit sipas datës më 31 Dhjetor 2012 sipas monedhave të huaja në të cilën ato u emërtuan ishin si më poshtë:

31 Dhjetor 2012	ALL	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktive					
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	2,630,007	4,246,659	547,659	105,065	7,529,390
Kredi dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	-	1,605,358	690,008	-	2,295,366
Instrumenta financiare të gatshme për shitje	3,639,250	840,532	-	-	4,479,782
Hua dhe paradhënie për klientët	12,858,737	9,214,246	701,795	-	22,774,778
Aktive të tjera financiare	118,987	29,432	2,516	146	151,081
Totali i Aktiveve Financiare	19,246,981	15,936,227	1,941,978	105,211	37,230,397
Detyrime					
Ndaj bankave	1,169,768	-	-	-	1,169,768
Ndaj klientëve	19,490,431	10,258,585	1,988,715	97,294	31,835,025
Fonde të tjera të marra hua	-	978,894	-	-	978,894
Detyrime të tjera financiare	170,804	57,476	3,064	-	231,344
Borxh i varur	-	1,301,633	-	-	1,301,633
Totali i detyrimeve Financiare	20,831,003	12,596,588	1,991,779	97,294	35,516,664
Pozicioni neto i monedhës në bilanc	(1,584,022)	3,339,639	(49,801)	7,917	1,713,733
Angazhime dhe garant jashtë bilancit	1,590,520	958,027	525,513	-	3,074,060

Analiza e ndjeshmërisë në monedhë të huaj

Banka ekspozohet kryesisht ndaj paqëndrueshmërisë së Euros dhe Usd dhe në një nivel më të ulët ekspozohet në paqëndrueshmërinë e GBP dhe CHF. Analiza e ndjeshmërisë së Bankës merr parasysh historikun e 7 viteve të fundit të luhatjes së normës së këmbimit në Lek ndaj monedhave të huaja; Euro dhe Usd. Këto janë normat e ndjeshmërisë të përdorura gjatë raportimit së brendshmi të risikut në monedhë të huaj tek menaxhimi kryesor. Bazuar në metoda statistikore, ato përfaqësojnë vlerësimin e menaxhimit të ndryshimeve të mundshme të arsyeshme në normat e kursit të këmbimit.

Është nën përgjegjësinë e degës së thesarit të bankës të mbajë pozicionin e monedhës brenda limiteve të caktuara. Në operacionet ditore, ajo vlerëson zhvillimet e normës së këmbimit të monedhës së huaj duke iu referuar të gjitha pozicioneve të monedhës materiale. Ndryshime të mëdha në strukturën e aktivitetit dhe pasivitetit të emërtuara

në monedhë të huaj dhe impakti i tyre duhet të rishikohet përpara se të bëhet biznes nga dega e thesarit.

Si parim themelor në lidhje me menaxhimin e risikut të monedhës së huaj, Banka nuk përfshihet në tregti prioritare dhe nuk investon në monedhë. Banka synon të mbyllë pozicionet e monedhës dhe garanton që pozicionet e hapura të monedhës mbeten brenda limitit gjatë të gjithë kohës. Meqënëse Banka e ka kapitalin e emërtuar në EUR, ndërsa operon në një vend që nuk ka EUR si monedhë, ajo ka një pozicion të aprovuar të monedhës së huaj për kapitalin. Bankës nuk i lejohet të hyjë në pozicione spekulative në tregjet e shkëmbimit të monedhës së huaj.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, nëse norma e kursit të këmbimit të monedhës LEK kundrejt Euros dhe Usd ka patur luhatje midis

përqindjes ekstreme 99 ose 1 në 7 vitet e fundit, humbja nga pozicioni i hapur i monedhës së bankës do të ishte 94, 300 mijë LEK (673 mijë Euro).

3.2 Risku i normës së interesit

VVeprimet e Bankës i nënshtrohen riskut të luhatjeve të normës së interesit në masën që aktiveve që gjenerojnë interes dhe detyrimeve mbartëse të interesit të maturohen ose të rëzohen në kohë të ndryshme ose në vlera të ndryshme. Banka përpiqet ta zvogelojë këtë risk nëpërmjet monitorimit të datave të rivendosjes së çmimit për aktivet dhe detyrimet e saj.

Për më tepër, efekti aktual do të varej nga një numër faktoresh të tjerë, duke përfshirë përmasën në të cilën shlyerjet kryhen më herët ose më vonë se datat e parashikuara në kontratë dhe variationet në ndryshimin e normës së interesit brenda periudhave të vendosjes së çmimeve të reja dhe ndërmjet monedhave.

Banka nuk ka për qëllim që të gjenerojë fitime nëpërmjet spekulimit në tregun e normës së interesit. Në të vërtetë, ajo përpiqet të garantojë për strukturën e saj të normës së interesit një ekuilibër sa më të mirë të mundshëm përgjatë të gjithë maturimeve. Qëllimi është përputhja e profileve të vendosjes së çmimeve të reja midis aktiveve dhe detyrimeve. Nëse kjo nuk është e mundur për arsye përjashtimore, derivatet e normës së interesit mund të përdoren vetëm për qëllime mbrojtje.

Kur banka konsideron regjistrimin e një transaksioni të ndryshëm të normës së interesit me një vlerë jo reale e cila tejkalon 5% të kapitalit rregullator dhe e cila ka një maturim më të gjatë në përcaktimin e çmimit tjetër sesa 6 muaj, njësia e thesarit të bankës ose çdo njësi tjetër e cila mund të kryejë transaksione me këto karakteristika, i duhet të konsultojë departamentin e menaxhimit të riskut të bankës përpara marrjes së vendimit. Pasi departamenti i menaxhimit të riskut të bankës të ketë verifikuar strukturën e normës së interesit pas transaksionit brenda limiteve të miratuara të normës së interesit dhe transaksioni të jetë miratuar nga ALCO, njësia e thesarit të bankës mund të ekzekutojë transaksionin.

Njësia front office e thesarit të Bankës realizon të gjitha normat e interesit të tregtimit. Përpara ndërmarrjes të ndonjë transaksioni me normë interesi, ajo duhet të konsultojë departamentin e menaxhimit të riskut të bankës dhe njësinë e grupit të menaxhimit të riskut të tregut. Menjëherë pas përfundimit të tregtisë, ajo duhet të regjistrojë transaksionet e normës së interesit në sistemet përkatëse për procesimin dhe kontrollin nga back office i thesarit të bankës dhe nga departamenti i menaxhimit të riskut të bankës.

Departamenti i menaxhimit të riskut të Bankës analizon efektet e ndryshimeve të rëndësishme të normës së interesit që mund të ketë në pasqyrat financiare (e cila rezulton nga, për shembull, financimi i ri aktual dhe i prituri, zona të reja të biznesit ose arrijtjen e maturimit të ekspozimeve). Nëse departamenti i menaxhimit të riskut në bankë identifikon ndryshime të dukshme të normave të interesit ose të strukturës së maturimit, një gep i modifikuar kohëzgjatje dhe një analizë e gepit të normës së interesit duhet të rillogaritet menjëherë.

Departamenti i menaxhimit të riskut rishikon të gjitha pozicionet e normës së interesit në të gjitha monedhat materiale të paktën çdo tre muaj dhe përpara çdo transaksioni i cili mund të jetë i madh sa për të ndikuar në riskun e normës së interesit në bankë.

ALCO i bankës dhe Komiteti i Menaxhimit të Riskut të bankës kanë autoritetin për të miratuar modifikimet e ekspozimeve të normës së interesit brenda limiteve të përcaktuara në këtë politikë. Limite më të larta janë të mundshme vetëm në raste përjashtimore dhe i nënshtrohen miratimit nga ALCO i Grupit ose Komiteti i Menaxhimit të Riskut të Grupit.

Departamenti i menaxhimit të riskut të bankës, në bashkëpunim me njësinë e thesarit të bankës, mund t'i japë rekomandime ALCOs dhe Komitetit të Menaxhimit të Riskut të bankës mbi veprime të mundshme.

Tabelat e mëposhtme paraqiten mbi bazën e kohës fillestare midis maturimit ose datës së vendosjes së çmimit të ri.

31 Dhjetor 2013	Deri në 1 muaj	1 – 3 muaj	3 – 6 muaj	6 – 12 muaj	Mbi vit	Jo mbartëse e interesit	Totali
Aktive							
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	6,066,433	–	–	–	–	2,749,388	8,815,821
Kredi dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	313,156	210,300	–	–	–	21,157	544,613
Instrumenta financiare							
të gatshme për shitje	340,200	1,400,000	1,347,053	1,966,318	–	(60,705)	4,992,866
Hua dhe paradhënie për klientët	2,972,402	1,546,040	3,007,207	4,429,511	12,907,957	(1,873,241)	22,989,875
Aktive të tjera financiare	–	–	–	–	–	455,419	455,419
Totali i Aktiveve Financiare	9,028,254	4,045,800	6,151,144	10,438,450	5,872,535	2,262,411	37,798,594
Detyrime							
Ndaj bankave	759,295	–	–	–	–	–	759,295
Ndaj klientëve	8,147,385	3,569,950	4,157,344	9,081,512	953,287	6,532,627	32,442,106
Fonde të tjera të marra hua	–	117,826	16,677	33,354	740,531	1,873	910,261
Detyrime të tjera financiare	–	–	–	–	–	209,030	209,029
Borxh i varur	–	–	–	–	1,258,094	49,935	1,308,029
Totali i detyrimeve Financiare	8,906,681	3,687,776	4,174,021	9,114,866	2,951,912	6,793,465	35,628,720
Hendeku i ndryshimit të së interesit							
	121,572	358,024	1,977,124	1,323,584	2,920,623	(4,531,053)	2,169,873

31 Dhjetor 2012	Deri në 1 muaj	1 – 3 muaj	3 – 6 muaj	6 – 12 muaj	Mbi vit	Jo mbartëse e interesit	Totali
Aktive							
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	3,033,878	-	-	-	-	4,495,512	7,529,390
Kredi dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	2,083,925	209,385	-	-	-	2,056	2,295,366
Instrumenta financiare të gatshme për shitje	339,590	1,839,590	1,498,102	872,255	-	(69,755)	4,479,782
Hua dhe paradhënie për klientët	1,125,040	1,334,770	2,571,378	4,266,093	14,815,617	(1,338,120)	22,774,778
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	151,081	151,081
Totali i Aktiveve Financiare	6,582,433	3,383,745	4,069,480	5,138,348	14,815,617	3,240,774	37,230,397
Detyrime							
Ndaj bankave	1,169,768	-	-	-	-	-	1,169,768
Ndaj klientëve	6,694,465	3,921,597	4,143,454	8,935,485	757,325	7,382,700	31,835,026
Fonde të tjera të marra hua	-	19,961	16,605	36,566	906,611	(849)	978,894
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	231,344	231,344
Borxh i varur	-	-	-	-	1,251,951	49,682	1,301,633
Totali i detyrimeve Financiare	7,864,233	3,941,558	4,160,059	8,972,051	2,915,887	7,662,877	35,516,665
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	(1,281,800)	(557,813)	(90,579)	(3,833,703)	11,899,730	(4,422,103)	1,713,732

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit është përcaktuar në bazë të ekspozimeve të normave të interesit për të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare në datën e raportimit. Këto norma përdoren kur raportohet së brendshmi risku i normës së interesit pranë menaxhimit kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e ndryshimeve të mundshme të arsyeshme të menaxhimit në normat e interesit.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, nëse normat e interesit në treg për monedhën Lek do të kishin qënë 250 pikë bazë më të larta me variablat e tjera të mbajtura konstante, fitimi para tatimit për vitin do të kishte qënë 32,905 mijë LEK (2012: 50,196 mijë LEK) më e ulët, kryesisht si rezultat i normave më të larta të shpenzimit të interesit në depozitat e klientëve krahasuar me normat e të ardhurave nga interesi të instrumentave financiare të gatshme për shitje dhe huave të klientëve.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, nëse normat e interesit në treg për monedhën Euro do të kishin qënë 200 pikë bazë më të larta me variablat e tjera të mbajtura konstante, fitimi para tatimit për vitin do të kishte qënë 51,125 mijë LEK (2012: 66,757 mijë LEK) më e lartë, kryesisht si rezultat i normave më të larta të shpenzimit të interesit në depozitat e klientëve dhe huamarrje krahasuar me të ardhurat nga normat e interesit në vendosjet me bankat dhe huave të klientëve.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, nëse normat e interesit në treg për monedhën Usd do të kishin qënë 200 pikë bazë më të larta me variablat e tjera të mbajtura konstante, fitimi pas tatimit për vitin do të kishte qënë 12,803 mijë LEK (2012: 14,578 mijë LEK) më e lartë, kryesisht si rezultat i normave më të ulëta të shpenzimit të interesit në depozitat e klientëve krahasuar me normat e të ardhurave nga interesi të zërit të arkës dhe llogaritë me Bankat. Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit përfshin të gjitha aktivet dhe detyrimet variabël të normave të interesit dhe supozon se të gjitha aktivet dhe detyrimet afatshkurtra me normë fiske do të rinvestohen pas mbarimit të maturimit.

3.3 Risku i Kredisë

TBanka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë nëpërmjet aktiv-

iteteve të saj huamarrëse si edhe në rastet kur ajo emeton letra të kredisë dhe garante në favor të klienteve të saj. Në këtë aspekt, risku i kredisë për Bankën buron nga mundësia që palë homologe të ndryshme të mund të mosplotësojnë detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimeve të riskut të kredisë për huamarrësit udhëhiqet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë për kredidhënie të huamarrësit dhe përcaktimit të normës së kreditimit. Ekspozimi i riskut të kredisë menaxhohet gjithashtu pjesërisht nëpërmjet sigurimit të kolateralit dhe garancive.

Ekspozimi kryesor i Bankës ndaj riskut të kredisë rrjedh nga kreditë dhe paradhwinit e saj. Vlera e ekspozimit të kredisë në këtë aspekt paraqitet nga vlera e mbartur e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Për më tepër, Banka ekspozohet në riskun e kredisë jashtë bilancit nëpërmjet angazhimeve në kredi të zgjata/ dhe garancive të rishikuara (shih shënimin 30).

Përqëndrimet e riskut të kredisë (qoftë brenda ose jashtë bilancit) të cilat rrjedhin nga instrumentat financiare ekzistojnë për palët homologe kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike të cilat do të ulnin aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushte ekonomike ose kushte të tjera. Përqëndrimet kryesore të riskut të kredisë rrjedhin nga lloji i klientit për sa i përket investimeve të Bankës, huatë dhe paradhwinit, angazhimet në kreditë e zgjata dhe garanci të rishikuara.

3.3.1 Kontrolli i limitit të riskut dhe politika e zbutjes/lehtësimi

Banka menaxhon, kufizon dhe kontrollon përqëndrimet e riskut të kredisë kurdoherë kur këto identifikohen – në veçanti, për kundërpalë dhe grupe individuale, dhe për biznese dhe shtete.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredive që ajo ndërmerr nëpërmjet përcaktimit të limiteve në vlerën e riskut të pranueshëm në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrësish dhe për segmente gjeografike dhe industriale.

Këto risqe monitorohen mbi një bazë rrotulluese dhe ekspozohen ndaj një rishikimi vjetor ose shumë të shpeshtë, kur shihet e nevojshme. Limitet e nivelit të riskut të kredisë të ndara sipas produktit dhe departamentit të biznesit miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi i riskut të kredisë menaxhohet gjithashtu nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur interesin dhe detyrimet e shlyerjes së kapitalit dhe nëpërmjet ndryshimit të këtyre limiteve të huadhënies kur shihet e nevojshme.

Disa kontrole të tjera specifike dhe masa zbutese nënvizohen më poshtë.

(a) Kolaterali

Banka përdor një sërë politikash dhe praktikash për të zbutur riskun e kredisë. Më tradicionalja e së cilave është marrja e sigurisë për paradhëniet e fondeve, praktikë kjo e përdorur gjërësisht.

Banka zbaton udhëzime mbi pranimin e klasave të veçanta të kolateralit ose të zbutjes së riskut të kredisë.

Llojet kryesore të kolateralit për kreditë dhe paradhëniet janë:

- Arka dhe garancitë e bankës,
- Hipoteka mbi banesat;
- Aktive biznesi si godina, inventare dhe llogari të arkëtueshme.

Huatë për njësitë ekonomike korporatë dhe individë në përgjithësi sigurohen. Në mënyrë që të minimizohet humbja nga kredidhënia Banka kërkon kolateral shtesë nga kundërpalët sapo vërehen treguesit e zhvlerësimit për huatë dhe paradhënie përkatëse për individë.

(b) Detyrime kredie

Qëllimi kryesor i këtyre instrumentave është të sigurohet që fondet të jenë të disponueshme për një klient sipas kërkesës. Garancitë dhe letrat në pritje të kreditit mbartin të njëjtin risk kredie si huatë dhe sigurohen me kolateral të njëjtë si huatë.

3.3.2 Zhvlerësimi dhe politikat e provigjonimit

Provigjonet e zhvlerësimit njihen për qëllime të raportimit financiar vetëm për humbje të cilat janë paraqitur në datën e raportimit bazuar në prova objektive të zhvlerësimit (shih Shënimin 2.n).

Mjeti i brendshëm i vlerësimit e ndihmon menaxhimin në përcaktimin nëse prova objektive e zhvlerësimit ekziston, bazuar në kriteret e mëposhtme të përcaktuara nga Banka:

- Shkelje të kontratës në shlyerjen e pagesës së principalit ose interesit;
- Vështirësi në gjenerimin e fluksit të parave nga huamarrësi (raportimi i kapitalit, përqindja neto e të ardhurave nga shitja);

- Shkelje e kontratës ose kushteve të kredisë;
- Nisja e procesit të falimentimit;
- Përkeqësimi i pozicionit konkurrues të huamarrësit;
- Përkeqësimi në vlerën e kolateralit.

Politika e Bankës kërkon rishikimin e aktiveve financiare individuale të cilat janë mbi cakun e materialitetit të paktën një herë në vit ose më rregullisht kur e kërkojnë rrethana të caktuara. Zbritjet nga zhvlerësimi në llogaritë e vlerësuara individualisht përcaktohen nga një vlerësim i humbjes së pësuar në datën e bilancit mbi bazën e një rast pas rasti dhe aplikohen në të gjitha llogaritë e rëndësishme individuale. Vlerësimi përfshin normalisht kolateralin e mbajtur (përfshirë rikonfirmimin e zbatueshmërisë së tij) dhe faturat pjesë-marrëse për llogarinë individuale.

Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit të një grupi të aktiveve financiare bazohet në një analizë sasiore të normave historike të mos shlyerjes së kredisë për portofole kredie me karakteristika të ngjashme risku. Normat sasiore të mos shlyerjes së kredisë të përlllogarituar në këtë mënyrë i nënshtrohen një analize cilësore (analiza e zbutjes/lehtësimit).

Sipas metodologjise së brendshme të bankës, klasifikimi kryhet nëpërmjet aplikimit të parimit të numrit të ditëve në vonesë në shlyerjen e detyrimeve të huasë nga klientët. Ky parim i numrit të ditëve në vonesë nënkupton organizimin e klasifikimit të mëposhtëm:

- Klasa e huave dhe arkëttimeve jashtë bilancit i korrespondon huave pa ditë në vonesë ose me një vonesë në shlyerje deri në 7 ditë;
- Klasa e huave dhe arkëttimeve jashtë bilancit i korrespondon huave me një vonesë në shlyerje nga 8 deri në 30 ditë;
- Klasa e huave dhe arkëttimeve jashtë bilancit i korrespondon huave me një vonesë në shlyerje nga 31 deri në 90 ditë;
- Klasa e huave dhe arkëttimeve jashtë bilancit i korrespondon huave me një vonesë në shlyerje nga 91 deri në 180 ditë;
- Klasa e huave dhe arkëttimeve jashtë bilancit i korrespondon huave me një vonesë në shlyerje mbi 180 ditë.

Numri i ditëve në vonesë nënkupton numrin e ditëve në vonesë në shlyerjen e interesit ose principalit nga data e caktuar deri në ditën e vendosjes së klasave të riskut. Në këtë mënyrë klasat e riskut organizohen çdo muaj.

Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e zërave brenda bilancit të Bankës përsa i përket huave dhe paradhënieve dhe zhvlerësimi i provigjonit për çdo kategori të Bankës:

Vlerësimi i bankës Në %	2013		2012	
	Hua dhe paradhënie	Provigjoni i zhvlerësimit	Hua dhe paradhënie	Provigjoni i zhvlerësimit
Zhvlerësime specifike	13.97	22.0	9.85	12.60
0-7 ditë në vonesë	75.50	1.2	79.60	1.1
8-30 ditë në vonesë	7.44	1.2	7.90	1.1
31-90 ditë në vonesë	0.58	50	0.47	50
91-180 ditë në vonesë	0.36	75	0.34	75
Mbi 180 ditë	2.15	100	1.84	100
	100.00	6.8	100	4.5

Huatë dhe paradhëniet përmbledhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Hua për klientë	Hua për bankat	Hua për klientë	Hua për bankat
As e vonuar në kohë dhe as i zhvlerësuar	18,040,589	544,613	18,917,150	2,295,366
E vonuar në kohë por jo e zhvlerësuar	3,237,387	–	2,683,369	–
E zhvlerësuar individualisht	3,455,001	–	2,360,769	–
Bruto	24,732,977	544,613	23,961,288	2,295,366
Minus: zbritje për zhvlerësim	(1,743,102)	–	(1,186,510)	–
Neto	22,989,875	544,613	22,774,778	2,295,366

3.3.3 Cilësia e portofolit të kredisë

Provizioni në total i zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet tek klientët në vitin e mbyllur më datë 31 Dhjetor 2013 është 1,743,102 mijë Lekë (31 Dhjetor 2012: 1,186,510 mijë Lekë). Informacione të mëtejshme të fondit të zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve për bankat dhe klientët paraqiten në Shënimin 7.

Kreditë e rëndësishme individuale monitorohen nga Komiteti i Riskut të Kredisë së Bankës. Nëse ka ndonjë provë objektive të përkeqësimit të një kredie individuale të rëndësishme, nevoja për zhvlerësim individual vlerësohet, duke marrë parasysh:

- Çdo faktor i cili mund të ndikojë në aftësinë e klientëve për të realizuar detyrimin e tij (për shembull çdo informacion specifik mbi biznesin e klientit, ndryshimet në mjedisin e tregut të klientit, gjendja e përgjithshme ekonomike;
- Ekspozimi agregat i klientit;
- Vlera e zbatueshme e kolateralit të mbajtur.

Për përlogaritjen e zhvlerësimit individual aplikohet metoda e Fluksit të Skontuar të Parasë.

(a) Hua dhe paradhënie as të vonuara në kohë dhe as të zhvlerësuara

Cilësia e kredisë së portofolit të huave dhe paradhënieve të cilat nuk ishin as të vonuara në kohë dhe as të zhvlerësuara mund të vlerësohet duke iu referuar sistemit të brendshëm të vlerësimit të adoptuara nga Banka. Të gjitha huatë dhe paradhëniet të cilat nuk janë as të vonuara në kohë dhe as të zhvlerësuara klasifikohen në kategorinë I të vlerësimit të Bankës (shënim 3.3.2). Tabelat e mëposhtme paraqesin një analizë të huave dhe paradhënieve për klientet nga kundërpala dhe cilësia e kredisë.

31 Dhjetor 2013	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
Standard	13,843,092	2,362,948	1,046,747	530,926	256,876	18,040,589
Të rishikuara specifikisht për zhvlerësim	–	–	–	–	–	–
Totali	13,843,092	2,362,948	1,046,747	530,926	256,876	18,040,589

31 Dhjetor 2012	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
Standard	14,862,261	1,970,930	1,203,337	541,964	338,658	18,917,150
Të rishikuara specifikisht për zhvlerësim	–	–	–	–	–	–
Totali	14,862,261	1,970,930	1,203,337	541,964	338,658	18,917,150

Kategoria standarde i përket huave 'as të vonuara në datë as të zhvlerësuara' për të cilat nuk identifikohet asnjë provë zhvlerësimi.

**(b) Hua dhe paradhënie të vonuara në kohë por jo të zhvlerësuara
loans and advances past due but not impaired**

Huatë dhe paradhëniet me më pak se 180 ditë në vonesë nuk konsiderohen të zhvlerësuara, nëse nuk disponohet një informacion tjetër që të tregojë të kundërtën. Shuma bruto e huave dhe paradhënieve sipas klasave të klientëve të cilet ishin në vonesë por jo të zhvlerësuar janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2013	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera
1- 7 ditë në vonesë	111,466	560	8,533	24,697	145,256
8- 30 ditë në vonesë	1,823,246	300,899	145,953	49,357	2,319,455
31 - 90 ditë në vonesë	105,099	21,605	13,346	10,760	150,810
91 – 180 ditë në vonesë	56,495	13,163	11,592	9,471	90,721
Mbi 180 ditë në vonesë	354,584	80,869	55,489	40,203	531,145
Totali	2,450,891	417,095	234,913	134,488	3,237,387
Vlera e drejtë e kolateralit	1,970,134	316,588	162,898	56,140	2,505,759

31 Dhjetor 2012	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera
1- 7 ditë në vonesë	133,951	2,262	13,799	5,436	155,448
8 - 30 ditë në vonesë	1,471,487	275,767	109,264	36,309	1,892,827
31 - 90 ditë në vonesë	73,399	11,372	15,729	10,903	111,403
91 – 180 ditë në vonesë	43,782	16,991	11,143	9,852	81,768
Mbi 180 ditë në vonesë	310,341	73,370	43,470	14,742	441,923
Totali	2,032,960	379,762	193,405	77,242	2,683,369
Vlera e drejtë e kolateralit	1,962,550	340,749	134,685	25,205	2,463,190

Shumat shpjeguese janë vlera bruto përpara zhvlerësimit.

(c) Hua dhe paradhënie për klientë të zhvlerësuar individualisht

Ndarjet e shumës bruto të huave dhe paradhënieve të zhvlerësuara individualisht sipas klasave, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit përkatës të mbajtur nga Banka si siguri, janë si më poshtë.

31 Dhjetor 2013	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
Hua të zhvlerësuara individualisht	2,602,471	828,593	23,709	–	228	3,455,001
Vlera e drejtë e kolateralit	1,824,796	281,026	23,709	–	–	2,129,531

31 Dhjetor 2012	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
Hua të zhvlerësuara individualisht	1,700,725	650,234	9,533	–	277	2,360,769
Vlera e drejtë e kolateralit	1,700,335	649,872	9,533	–	–	2,359,740

Vlera e drejtë e kolateralit të paraqitur përcaktohet nga vlerësues vendas të certifikuar dhe ajo përfaqëson vlera të realizueshme nga pronarët e ligjshëm të aktiveve.

Menaxhimi i konsideron kreditë e mbuluara nga kolaterali si të zhvlerësuara sepse eksperiencia tregon se një pjesë e konsiderueshme e kolateralit nuk mund të zbatohet si rezultat i vështirësive administrative dhe ligjore si psh vonesa në procesin ligjor dhe në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës. Provigjonet e zhvlerësimit pasqyrojnë probabilitetin se menaxhimi nuk do të ketë të mundur të imponojë të drejtat e tij dhe të rizotërojë kolateralin për kreditë e papaguara defaulted. Pavarësisht vështirësive në zbatimin e rizotërimit të kolateralit, menaxhimi i bankës do të ndjekë rigorozorishet borxhet aktive me të gjitha mjetet e mundshme në dispozicion.

Faktorët të cilët merren parasysh në përcaktimin e arkëtimeve individualisht të zhvlerësuara janë si më poshtë:

- Shkelje të kontratës në shlyerjen e pagesës së principalit ose interesit prej më shumë se 30 ditë;
- Shkelje e kontratës ose kushteve të kredisë;
- Inicimi i procesit të falimentimit
- Çdo informacion specifik në biznesin e klientit (psh. të pasqyruara nga vështirësitë e fluksit të parasë të përjetuar nga klienti);
- Ndryshimet në mjedisin e tregut të klientit;
- Gjendja e përgjithshme makroekonomike.

3.3.4 EMkspozimi maksimal i riskut përpara mbajtjes së kolateralit

Tabela e mëposhtme paraqet ekspozimin për riskun e kredisë në vlin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 e cila tregon ekspozimin në total të riskut të kredisë pa marrë parasysh mjetet e kolateralit. Për aktivet brenda bilancit, ekspozimet e strukturuara sa më sipër bazohen në vlerën e mbartur neto siç raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar. Tabela përfshin gjithashtu zërat jashtë bilancit të cilat mund të gjenerojnë risk kredie.

	Ekspozimi maksimal	
	2013	2012
Ekspozimet e riskut të kredisë të lidhura me aktivet brenda bilancit janë si më poshtë:		
Arka dhe llogaritë me		
Bankën Qendrore	8,815,821	7,529,390
Hua dhe paradhënie për banka dhe institucione të tjera financiare		
	544,613	2,295,366
Hua dhe paradhënie për klientë:		
Biznes	17,785,259	17,728,231
Bujqësi	3,137,568	2,799,392
Shtëpi	1,209,099	1,328,591
Konsumator	596,691	575,716
Të tjera	261,258	342,848
	22,989,875	22,774,778
Instrumenta financiare të gatshme për shitje		
	4,992,866	4,479,782
Aktive të tjera financiare		
	455,419	147,925
Ekspozimet e riskut të kredisë të lidhura me aktivet jashtë bilancit janë si më poshtë:		
Angazhimet në kredi dhe detyrime të tjera të lidhura të kredisë		
	2,096,251	2,071,706
Garanci financiare		
	728,995	683,098
Totali	39,894,845	39,982,045

Struktura e portofolit të kredisë rishikohet rregullisht brenda bankës në mënyrë që të identifikojë ngjarjet potenciale të cilat mund të kenë një impakt në zonat e gjëra të portofolit të kredisë (faktorë të përbashkët të riskut) dhe kur shihet e nevojshme të limitojë ekspozimin ndaj disa sektorëve të ekonomisë.

31 Dhjetor 2013	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
< 30,000 EUR	5,471,700	1,321,761	840,960	558,981	197,216	8,390,618
30,000 – 150,000 EUR	7,119,914	1,055,828	368,139	37,710	64,226	8,645,817
> 150,000 EUR	5,193,460	759,980	–	–	–	5,953,440
Totali	17,785,074	3,137,569	1,209,099	596,691	261,442	22,989,875

31 Dhjetor 2012	Biznes	Bujqësi	Shtëpi	Konsumator	Të tjera	Totali
< 30,000 EUR	5,752,272	1,222,713	1,059,333	560,182	254,652	8,849,152
30,000 – 150,000 EUR	6,925,097	787,597	269,258	15,534	88,196	8,085,681
> 150,000 EUR	5,050,863	789,082	–	–	–	5,839,945
Totali	17,728,232	2,799,392	1,328,591	575,716	342,848	22,774,778

3.3.5 Hua dhe paradhënie të rinegociuara

Aktivitetet rrikturuese përfshijnë marrëveshje të zgjatura pagese, modifikime dhe shtyrje të pagesës. Në ndjekje të rrikturimit, një klient i vonuar më parë në shlyerjen e kredisë i jepet statusi normal dhe menaxhohet së bashku me llogari të tjera të ngjashme. Politi-

kat dhe praktikat rrikturuese bazohen në treguesit ose në kri-teret të cilat, sipas gjykimit të menaxhimit të bankës, tregojnë se pagesa ka shumë mundësi që të vazhdojë. Këto politika mbahen nën vëzhgim të vazhdueshëm. Huatë e rinegociuara të cilat nëse gjerat do të kishin qënë ndryshe do të ishin në vonesë në shlyerje ose të zhvlerësuar totalizohen në 1,848,258 mijë Lekë (2011: 1,154,259 mijë Lekë).

	2013		2012	
	Bilanc aktiv	Numri i huave	Bilanc aktiv	Numri i huave
Biznes	1,615,850	339	1,024,098	301
Bujqësi	151,283	94	83,752	80
Shtëpi	61,410	82	30,874	79
Konsumator	19,715	100	15,535	57
Totali	1,848,258	615	1,154,259	517

3.3.6 Kolateral i rimarrë

Kolaterali i siguruar nëpërmjet procesit ligjor përfshin tokën, ndërtesën dhe godinat e biznesit të cilat nuk janë në përdorim nga Banka. Kolaterali i siguruar si rezultat i procesit ligjor duhet të shitet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3.3.7 Politika e kolateralit

Kolaterali përfshin arkën, hipotekat, inventarin dhe të tjera aktive të lëna peng në favor të bankës nga huamarrësit e saj dhe në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 kapnin vleren prej 24,609,222 mijë Lekë (2012: 23,950,760 mijë Lekë). Kolaterali vlerësohet në datën kur kredia zgjatet dhe rivlerësohet periodikisht për zhvlerësim.

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e kredive të bankës, paradhënive bankare dhe kartave të kreditit nëpërmjet llojit të parë të garancisë, duke përjashtuar interesin e përlllogaritur dhe tarifën e disbursimit nga kreditë:

Lloji i parë i garancisë	31 Dhjetor 2013	%	31 Dhjetor 2012	%
Hipoteka	383,389	2	381,422	2
Kolateral tjetër	1,636,196	7	1,551,156	6
I përzier (Hipotekë dhe të tjera)	22,257,815	90	21,717,467	91
I pasiguruar	331,822	1	300,715	1
Totali	24,609,222	100	23,950,760	100

3.3.8 Struktura dhe shumëllojshmëria e portofolit të kredisë

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e huave të bankës, overdrafteve dhe kartave të kreditit sipas sektorit të industrisë, duke përjashtuar interesin e përlllogaritur dhe tarifën e disbursimit nga huatë:

Sektori i Biznesit	31 Dhjetor 2013	%	31 Dhjetor 2012	%
Tregti	8,672,654	35	8,089,424	34
Industri dhe prodhime të tjera	3,446,034	14	3,221,039	13
Ndërtim	755,898	3	839,815	4
Transport	648,751	3	753,803	3
Shërbime	6,350,761	26	7,109,452	30
Të tjera	4,735,122	19	3,937,228	16
Totali	24,609,222	100	23,950,761	100

3.3.9 Angazhimet e lidhura me kredinë

Qëllimi kryesor i këtyre instrumentave është të garantojë që fondet të jenë të disponueshme për klientin sipas kërkesës. Garancitë dhe letrat në pritje të kredisë, të cilat përfaqësojnë një garanci të përvokueshme që Banka do të marrë pagesat në rastin kur një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj një pale të tretë, mbartin të njëjtin risk kredie si huatë. Garancitë ose letrat e kredisë i nënshtrohen të njëjtit mekanizëm miratimi si huatë e rregullta. Kjo nënkupton gjithashtu se të njëjtat kërkesa kolaterali aplikohen për angazhimet jashtë bilancit si për huatë. Për më tepër, banka mat ekspozimin në total të klientit dhe besueshmërinë në dhënien e kredisë duke shtuar gjithashtu angazhimet jashtë bilancit tek ajo dhe duke marrë në konsideratë palët e lidhura dhe ekspozimin dhe besueshmërinë e tyre.

3.4 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit gjenerohet në fondet e përgjithshme të aktiviteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ajo përfshin si riskun në pamundësinë për të financuar aktive në maturimin e duhur dhe normat dhe riskun në pamundësinë për të likuiduar një aktiv me

një çmim të arsyeshëm dhe brenda një kuadri kohor të caktuar për të përmbushur detyrimet e borxhit.

Fondet realizohen nëpërmjet përdorimit të një numri të gjërë instrumentesh duke përfshirë depozitat, detyrime të tjera të vëna re me shkrim dhe kapitali aksioner. Kjo rrit mundësinë e fleksibilitetit të fondeve, limiton varësinë mbi çdo burim të fondeve dhe ul në përgjithësi koston e fondeve.

Banka përpiqet maksimalisht të sigurojë një ekuliber midis vazhdimësisë së fondit/financimit dhe fleksibilitetit nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me një variacion maturimesh. Banka vlerëson në mënyrë të vazhdueshme riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financimin e kërkuar për të përmbushur objektivat dhe synimet e biznesit të përcaktuara në strategjinë e përgjithshme të Bankës.

Për më tepër Banka zotëron një portofol të aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të riskut të likuiditetit.

Tabela e mëposhtme paraqet fluksin e parasë që pritet të paguhet nga Banka nën zërin e detyrimeve financiare nëpërmjet maturimeve

kontraktuale të shprehura në datën e raportimit. Vlerat e paraqitura në tabelë janë flukset kontraktuale të skontuara të parasë, ndër-kohë që Banka menaxhon riskun e trashëguar të likuiditetit bazuar në hyrjet e pritshme të skontuara të parasë.

31 Dhjetor 2013	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Detyrime					
Ndaj bankave	759,295	-	-	-	759,295
Ndaj klientëve	14,807,062	3,671,434	13,489,493	996,163	32,964,152
Fonde të tjera të marra hua	-	22,307	86,833	1,193,860	1,303,000
Detyrime të tjera	246,292	-	-	-	246,292
Borxh i varur	37,525	32,478	96,632	1,824,955	1,991,589
Totali i detyrimeve					
(sipas datave të caktuara në kontratë)	15,850,174	3,726,219	13,672,957	4,014,977	37,264,328
Totali i Aktiveve					
(sipas datave të caktuara të pritshme)	10,998,367	3,640,677	12,705,375	14,583,789	41,928,208

31 Dhjetor 2012	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Detyrime					
Ndaj bankave	1,169,768	-	-	-	1,169,768
Ndaj klientëve	13,244,037	352,575	13,568,637	5,165,958	32,331,207
Fonde të tjera të marra hua	-	23,572	209,107	1,167,561	1,400,240
Detyrime të tjera	284,812	-	-	-	284,812
Borxh i varur	29,052	92,527	72,058	1,867,485	2,061,121
Totali i detyrimeve					
(sipas datave të caktuara në kontratë)	14,727,669	468,674	13,849,802	8,201,004	37,247,149
Totali i Aktiveve					
(sipas datave të caktuara të pritshme)	10,847,147	3,718,921	9,984,954	20,050,922	44,601,945

3.5 Vlerësimi dhe paraqitja e vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në pasqyrat ekzistuese të pozicionit financiar të instrumentave financiare pa u përpjekur të vlerësojnë vlerën e biznesit që pritet në të ardhmen dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve jo të konsideruara në instrumentat financiare.

	Vlera e mbartur		Vlera e drejtë	
	2013	2012	2013	2012
Aktive Financiare				
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	8,815,821	7,529,390	8,815,821	7,529,390
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	22,989,875	22,774,778	23,927,164	22,998,567
Biznes	17,785,075	17,728,232	18,412,803	17,877,567
Bujqësi	3,137,568	2,799,392	3,301,980	2,820,240
Shtëpi	1,209,099	1,328,591	1,236,105	1,393,138
Konsumatorë dhe të tjerë	858,133	918,563	976,276	907,622
Hua dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	544,613	2,295,366	544,613	2,295,366
Instrumenta financiare të gatshme për shitje	4,992,866	4,479,782	4,992,866	4,479,782
Aktive të tjera financiare	427,407	147,925	427,407	147,925
Detyrime financiare				
Ndaj bankave	759,295	1,169,768	759,295	1,169,768
Ndaj klientëve	32,442,106	31,835,025	33,140,301	32,334,663
Fonde të tjera të marra hua	910,261	978,894	910,261	978,894
Borxh i varur	1,308,029	1,301,633	1,308,029	1,301,633
Detyrime të tjera financiare	209,030	231,344	209,030	231,344

Detyrime dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare

Huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe zërat në rrjedhën e grumbullimit. Përdërisa huatë, paradhëniet dhe depozitat e përnjënatshme janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet si e përafërt me vlerën e tyre të mbartur.

Hua dhe paradhënie ndaj klientëve

Huatë dhe paradhëniet janë zbritjet neto për zhvlerësim. Portofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë të drejtë të përafert të barabartë me vlerën e saj kontabël si rezultat i natyrës afatshkurtër ose i normave themelore të interesit, të cilat përafrojnë normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë i nënshtrohet vendosjes së çmimit të ri brenda një viti.

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve ndaj klientëve është fluksi i tyre i pritshëm i parasë i skontuar në normat aktuale të tregut. Normat aktuale të tregut janë normat e interesit të cilat ne do të tarifojmë për momentin (në fund të vitit).

Ndaj bankave dhe klientëve

Vlera e drejtë e vlerësuar e depozitave pa maturim të përcaktuar, e cila përfshin depozitat jo mbartëse të interesit, është shuma për tu paguar sipas kërkesës. Më 31 Dhjetor 2013, vlera e drejtë e depozitave me afat ishte 33,140,301 mijë Lekë (31 Dhjetor 2012: 32,334,663 mijë Lekë), ndërsa vlera e saj e mbartur ishte 32,442,106 mijë Lekë (31 Dhjetor 2012: 31,835,025 mijë Lekë).

Vlera e drejtë e vlerësuar/parashikuar e depozitave me afat përllogaritet duke skontuar fluksin e parasë në datat e pranuar me normat e depozitave në fundvit të cilat janë maturuar në më shumë se 6 muaj dhe ku norma aktuale e interesit nuk është e njëjta si ajo e rënë dakord për këto depozita.

Fonde të tjera të marra hua

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, vlera e drejtë e parashikuar e fondeve të marra hua është përafërsisht sa vlera e mbartur për shkak të normës së interesit e cila është përafërsisht me normat e tregut (shënim 17).

Borxhi i varur

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, vlera e drejtë e parashikuar e borxhit të varur është përafërsisht sa vlera e mbartur për shkak të normës së interesit e cila është e përafert me normat e tregut (shënim 18).

Instrumentat financiarë të matura me vlerën e drejtë

Hierarkia e mëposhtme është përdorur nga Banka në përcaktimin e vlerave të drejta të gatshme për shitje më datë 31 Dhjetor 2013 dhe 2012:

Niveli 2: Inpute jo vetëm çmime të kuotuar të përfshira brenda Nivelit 1 të cilat vëzhgohen për aktivet ose detyrimet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë (dmth si çmimet) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (dmth të rrjedhura nga çmimet).

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat e drejta të këtyrë aktiveve financiare të cilat maten me vlerën e drejtë të datës 31 Dhjetor 2013 dhe 2012:

Instrumenta financiare te gatshme per shitje

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Bono Thesari	4,149,999	3,639,250
Obligacione	842,645	840,311
Aksione	222	221
	4,992,866	4,479,782

3.6 Menaxhim i Kapitalit

Objektivat e Bankës në menaxhimin e kapitalit, e cila është një koncept më i gjërë sesa "kapitali neto" në bilanc, janë:

- të pajtohet me kërkesat e kapitalit të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë
- të ruaje aftësinë e Bankës për ta vazhduar si një shqetësim në progres në mënyrë që ajo të mund të vazhdojë të sigurojë kthime për aksioneret dhe përfitime për palët e tjera të interesit dhe;
- të ruajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo ditë nga menaxhimi i Bankës, duke vënë në funksion teknikën të bazuar në udhëzime të zhvilluara nga Komiteti Basel dhe Direktivat e Komunitetit Europian, siç implementohen nga Banka e Shqipërisë, për qëllime mbikëqyrjeje. Informacioni i kërkuar arkivohet në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj.

Banka e Shqipërisë i kërkon çdo banke ose Grupi bankar të: (a) sigurojë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 1 miliardë Lekë dhe (b) të mirëmbajë një raport të totalit të kapitalit rregullator në aktivet e ponderuara me risk ('Raporti Basel') në ose mbi minimumin ndërkombëtar të pranuar prej 12%.

Kapitali rregullator i Bankës i menaxhuar nga Departamenti i Riskut ndahet në dy kategori:

- Kapitali Tier 1: kapitali aksioner (shuma neto e çdo vlere kontabël e aksioneve të thesarit), fitimet e pashpërndara dhe rezervat e krijuara nga përvetësimet e fitimeve të pashpërndara; dhe
- Kapitali Tier 2: kapitali i borxhit të varur kualifikues, zbritjet e përbashkëta të zhvlerësimit dhe fitimet e parealizuara që shfaqen në vlerësimin e drejtë të kapitalit dhe instrumentat e borxhit të gatshme për shitje.

Aktivët e ponderuara me risk maten nëpërmjet hierarkisë së rëndësisë së katër risqeve të klasifikuar sipas natyrës të çdo aktivi dhe pale homologe, duke marrë parasysh çdo kolateral të pranueshem apo garanci – dhe duke pasqyruar një vlerësim të kredisë, tregut dhe risqeve të tjera të lidhura. Në të njëjtën mënyrë trajtohet dhe ekspozimi jashtë bilancit, me disa rregullime për të pasqyruar natyrën eventuale të humbjeve të mundshme.

Tabela e mëposhtme përmbledh përbërjen e kapitalit rregullator dhe raportet e Bankës për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012. Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 Banka ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e jashtme të kapitalit.

Zbritjet përfaqësojnë investimet në institucionet financiare për shumën mbi 10% dhe aktivet e patrupëzuara. Aktivet e patrupëzuara janë gjithashtu një shumë e zbritshme nga kapitali Tier I dhe Tier II.

	2013	2012
Kapitali Tier 1		
Kapitali aksioner	3,387,148	2,965,682
Rezervat statutore	590,681	587,690
Efekt i rivlerësimit për raportimin statutor	215,814	202,837
Fitimet e pashpërndara statutore	(284,925)	338,645
Totali i kapitalit kualifikues Tier 1	3,908,718	4,094,854
Kapitali Tier 2		
Shuma neto e detyrimeve të varura të zbritjeve statutore	1,025,506	867,497
Totali i kapitalit kualifikues Tier 2	1,025,506	867,497
Zbritje nga kapitali rregullator		
Aktivët e patrupëzuara statutore	(223,837)	(215,283)
Humbjet statutore per vitin	(388,217)	(595,365)
Totali i kapitalit rregullator	4,322,170	4,151,703
Aktivët e ponderuara me risk:		
Brenda Bilancit	28,959,494	29,396,711
Jashtë Bilancit	1,320,515	1,268,706
Totali i aktiveve të ponderuara me risk	30,280,009	30,665,417
Raporti CAR	14.27%	13.54%

4. Vlerësimet dhe gjykimet kritike kontabël gjatë aplikimit të politikave kontabël

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues. Vlerësimet dhe gjykimet performohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritsmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat mendohen të jenë të arsyeshme në varësi të rrethanave.

4.1 Humbje nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëniet

Banka shqyrton portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin në bazë mujore. Gjatë përcaktimit nëse humbjet nga zhvlerësimi duhen regjistruar në pasqyrën e humbjeve apo fitimeve, Banka shqyrton faktin nëse ka të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rritje mesatare të fluksit monetar të ardhshëm në portofolin e kredisë përpara se kjo rritje të evidentohet me një hua individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e dukshme që tregojnë se ka patur një ndryshim të kundërt në statusin e pagesës së huamarrësve në grup, ose në gjendjen ekonomike vendase apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në Bankë. Menaxhimi përdor vlerësimet e bazuara në eksperiencat e humbjeve historike për aktivet me karakteristikë të riskut të kredisë dhe evidenca objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol gjatë planifikimit të fluksit të ardhshëm të parasë. Metodika dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e të dyjave, shumës dhe afatit të fluksit monetar të ardhshëm, rishikohen rregullisht në mënyrë që të reduktohen diferencat midis vlerësimit të humbjeve dhe eksperiencës së humbjeve aktuale.

Humbjet nga zhvlerësimi për hua individuale të rëndësishme bazohen në vlerësimet e fluksit monetar të ardhshëm të zbritur tek huatë individuale, duke marrë parasysh shlyerjet dhe realizimin e aktiveve të mbajtura si kolateral kundrejt huave. Zhvlerësimet e huave të paraqitura më parë si të fshira ishin në shumën 56,150 mijë Lekë në vitin 2013 (2012; 69,668 mijë Lekë) si rezultat i zbatimit të rreptë nga Banka të politikës së fshirjes së huave si dhe si rezultat i rritjes së përpjekjeve për të ekzekutuar kolateralin.

4.2 Shqetësim i vazhdueshëm

Menaxhimi i përgatit këto pasqyra financiare në bazë të shqetësimit të vazhdueshëm. Gjatë këtij gjykimi, Menaxhimi mori parasysh gjendjen financiare të Bankës, synimet aktuale, fitueshmërinë e veprimtarisë dhe aksesin në burimet financiare, si dhe analizoi ndikimin e krizës financiare të kohëve të fundit tek veprimtaritë e ardhshme të Bankës.

5. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Arka		
Para në dorë	1,287,971	1,432,424
Llogari rrjedhëse		
Jo rezident	4,325,400	2,543,514
Banka Qendrore		
Llogari Rrjedhese	453,062	518,465
Vlerat monetare në tranzit	-	2,152
Nëntotali i përfshirë në arkë dhe ekuivalentet e saj (shënimi 29)		
Rezervat statutore	2,749,388	3,034,987
Totali	8,815,821	7,529,390

Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore nuk janë për përdorim të përditshëm nga ProCredit Bank dhe përfaqësojnë një depozitë minimale rezervë të kërkuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Këto rezerva llogariten si një përqindje prej 10% mbi shumën për tu paguar ndaj klientëve me maturim origjinal më të ulët ose të barabartë me 24 muaj. Këto rezerva mbahen në Lek (për të gjitha depozitat në Lek), në Euro (për monedhën Euro dhe valutat e tjera të huaja, psh. GBP, CHF) dhe në USD (për depozitat në USD).

6. Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare

Huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Llogaritë e depozitave		
Jo rezident	523,360	2,293,454
Nëntotali i llogarive të depozitave	523,360	2,293,454
Të tjera	21,253	1,912
Totali	544,613	2,295,366
Rrjedhëse		
Jo rrjedhëse	-	-

Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare përfshijnë arkën dhe ekuivalentet e saj (shënimi 28) më 31 Dhjetor 2013 në shumën prej 523,360 Lekë (31 Dhjetor 2012: 2,293,454 Lekë).

Llogari të tjera përfshijnë depozitat për leter krediti dhe garanci. Më datë 31 Dhjetor 2013, 100% e depozitave (31 Dhjetor 2012: 100%) mbaheshin në bankat e vendeve të OECD dhe kanë maturim kontraktual deri në tre muaj.

Depozitat me banka më datë 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Kundërpala	S&P FITCH	CCY	Balanca outstanding në valutën origjinale	Balanca totale ekuivalente në '000 LEK
Erste Group Bank AG	A	USD	3,000,233	305,604
Bank of America	A	USD	72,973	7,433
Bank fuer Orden und Mission	A+	EUR	1,500,163	210,323
Totali				523,360

Huatë për institucionet financiare më datë 31 Dhjetor 2012 detajohen si më poshtë:

Kundërpala	S&P FITCH	CCY	Balanca outstanding në valutën origjinale	Balanca totale ekuivalente në '000 LEK
Erste Group Bank AG	A	USD	6,500,666	688,095
FFT SPARKASSE	A+	EUR	2,000,031	279,184
Bank fuer Orden und Mission	A+	EUR	1,500,208	209,414
KBC BE	A-	EUR	4,000,156	558,382
INTESAMM	A-	EUR	2,500,081	348,986
UniCredit S.p.A.	A-	EUR	1,500,048	209,393
Totali				2,293,454

7. Hua dhe paradhënie per Klientet

Huatë dhe paradhëniet përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
